



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 33

13 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 88/2013 datë 21.2.2013	Për ratifikimin e ndryshimeve të konventës “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”..... 1357
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 2, datë 27.2.2013	Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale për vitin 2013..... 1364
Udhëzimi i MMPAU nr. 2, datë 6.3.2013	Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup-ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, mirëmbajtje e prerje ripërtëritëse, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera drusore e jodrusore..... 1365
Urdhër i MPPT nr. 19, datë 26.2.2013	Për miratimin e “Programit kombëtar të kontrollit të cilësisë së sigurisë në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë”..... 1388
Vendim i ERE nr. 26, datë 28.2.2013	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s për vitin 2012..... 1388
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fejzo Veip Kucuku... 1389

LIGJ
Nr. 88/2013

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMEVE TË KONVENTËS “PËR MBROJTJEN FIZIKE TË
MATERIALEVE BËRTHAMORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen ndryshimet të konventës “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8045, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**AMENDIMI I KONVENTËS MBI MBROJTJEN FIZIKE TË MATERIALEVE
BËRTHAMORE**

1. Titulli i Konventës mbi Mbrojtjen Fizike të Lëndëve Bërthamore të miraturar më 26 tetor 1979 (më poshtë e quajtur “Konventa”) zëvendësohet me titullin e mëposhtëm:

“KONVENTA
MBI MBROJTJEN FIZIKE TË LËNDËVE DHE IMPIANTEVE BËRTHAMORE”

2. Hyrja e Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“ SHTETET PALË TË KËSAJ KONVENTE,

duke pranuar të drejtën e të gjitha shteteve për të zhvilluar dhe aplikuar energjinë bërthamore për qëllime paqësore dhe interesat e tyre të ligjshme në përfitimet e mundshme që rrjedhin nga aplikimi paqësor i energjisë bërthamore;

të bindur për nevojën për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe transferimin e teknologjisë bërthamore për aplikimin paqësor të energjisë bërthamore;

duke marrë në konsideratë se mbrojtja fizike është e një rëndësie themelore për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë, mjedisit dhe sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare;

duke pasur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit midis Shteteve;

duke pasur parasysh se sipas kushteve të paragrafit 4 të nenit 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, “Në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare, të gjithë anëtarët nuk do të ushtrojnë kërcënim ose



përdorin forcë kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti ose në ndonjë mënyrë tjetër të papajtueshme me qëllimet e Kombeve të Bashkuara”;

duke rikujtuar Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar bashkëlidhur rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 49/60 të 9 dhjetorit 1994;

me dëshirën për të shmangur rreziqet e mundshme nga trafikimi i paligjshëm, marrjen dhe përdorimin e paligjshëm të materialeve bërthamore dhe sabotazhin e materialeve dhe impianteve bërthamore, dhe duke vërejtur se mbrojtja fizike kundër këtyre akteve është bërë çështje kombëtare dhe ndërkombëtare gjithnjë e më shqetësuese;

thellësisht të shqetësuar prej përshkallëzimit në të gjithë botën të akteve të terrorizmit në të gjitha format dhe shfaqjet e tij, dhe prej kërcënimeve nga terrorizmi ndërkombëtar dhe krimi i organizuar;

duke besuar se mbrojtja fizike luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e mospërhapjes bërthamore dhe objektivave kundër terrorizmit;

me dëshirën, nëpërmjet kësaj Konvente, për të kontribuar në forcimin në të gjithë botën të mbrojtjes fizike të materialeve dhe impianteve bërthamore të përdorura për qëllime paqësore;

të bindur se veprat penale në lidhje me materialet dhe impiantet bërthamore janë çështje shqetësimi serioz dhe se ekziston një nevojë urgjente për marrjen e masave të përshtatshme dhe efektive, ose për të forcuar masat ekzistuese, për të garantuar parandalimin, zbulimin dhe dënimin e këtyre veprave penale;

me dëshirën për të forcuar më tej bashkëpunimin ndërkombëtar për të vendosur, në përputhje me ligjin kombëtar të secilit shtet palë dhe me këtë Konventë, masa efektive për mbrojtjen fizike të materialeve dhe impianteve bërthamore;

të bindur se kjo Konventë duhet të plotësojë përdorimin e sigurt, ruajtjen dhe transportin e materialeve bërthamore dhe operimin e sigurt të impianteve bërthamore;

duke pranuar se ekzistojnë rekomandime të formuluar ndërkombëtarisht për mbrojtjen fizike, të cilat përditësohen herë pas here, të cilat mund të ofrojnë udhëzim mbi mjetet bashkëkohore për arritjen e niveleve efektive të mbrojtjes fizike;

duke pranuar, gjithashtu, se mbrojtja fizike efektive e materialeve dhe impianteve bërthamore të përdorura për qëllime ushtarake është përgjegjësi e shtetit që zotëron këto materiale dhe impiante bërthamore, dhe duke kuptuar se këtyre materialeve dhe impianteve bërthamore u është dhënë dhe do të vazhdojë t’u jepet mbrojtje e rreptë fizike,

kanë rënë dakord si më poshtë:”.

3. Në nenin 1 të Konventës, pas paragrafit (c) shtohen dy paragrafë të rinj me tekstin e mëposhtëm:

“d) “impiant bërthamor” nënkupton një impiant (duke përfshirë godinat dhe pajisjet përkatëse) në të cilin prodhohet, përpunohet, përdoret, trajtohet, ruhet ose asgjësohet materiali bërthamor, nëse dëmi ose ndërhyrja në këtë impiant mund të çonte në çlirimin e sasive të konsiderueshme rrezatimi ose të materialit radioaktiv;

e) “sabotazh” nënkupton çdo akt të qëllimshëm të drejtuar kundër një impianti ose materiali bërthamor në përdorim, ruajtje ose transport që mund të rrezikonte drejtpërdrejt ose tërthorazi shëndetin dhe sigurinë e personelit, publikut ose mjedisit nga ekspozimi i rrezatimit ose çlirimi i lëndëve radioaktive.”.

4. Pas nenit 1 të Konventës shtohet neni i ri 1A me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 1A

Qëllimet e kësaj Konvente janë arritja dhe ruajtja në shkallë botërore e mbrojtjes fizike efektive të materialeve bërthamore të përdorura për qëllime paqësore dhe të impianteve bërthamore të përdorura për qëllime paqësore; për të parandaluar dhe luftuar veprat penale në lidhje me këto materiale dhe impiante në të gjithë botën; si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë për këto qëllime.”

5. Neni 2 i Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1. Kjo Konventë zbatohet për materialin bërthamor të përdorur për qëllime paqësore në përdorim, ruajtje dhe transport dhe për impiante bërthamore të përdorura për qëllime paqësore, megjithatë, me kusht që nenet 3 dhe 4 dhe paragrafi 4 i nenit 5 të kësaj Konvente të zbatohen vetëm për këtë material bërthamor gjatë transportit ndërkombëtar bërthamor.

2. Përgjegjësia për krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një regjimi të mbrojtjes fizike brenda një shteti palë i përket tërësisht atij shteti.

3. Përveç angazhimeve të ndërmarra shprehimisht nga shtetet palë sipas kësaj Konvente, asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur cenon të drejtat sovrane të një shteti.

4.a) Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të shteteve palë sipas të drejtës ndërkombëtare, në veçanti qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare.

b) Veprimtaritë e forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur, siç këto terma kuptohen sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare që rregullohen nga ky ligj, nuk rregullohen nga kjo Konventë dhe veprimtaritë e ndërmarra nga forcat ushtarake të një shteti në ushtrimin e të drejtave të tyre zyrtare, në masën që rregullohen nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare, nuk rregullohen nga kjo Konventë.

c) Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si autorizim i ligjshëm për të përdorur ose rrezikuar përdorimin e forcës kundër materialeve ose impianteve bërthamore të përdorura për qëllime paqësore.

d) Asgjë në këtë Konventë nuk lejon ose ndryshe bën të ligjshme akte të paligjshme, as nuk përjashton ndjekje penale sipas ligjeve të tjera.

5. Kjo Konventë nuk zbatohet për materialin bërthamor të përdorur ose të ruajtur për qëllime ushtarake ose për një impiant bërthamor që përmban material të tillë.”.

6. Pas nenit 2 të Konventës shtohet neni i ri 2A me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 2A

1. Çdo shtet palë krijon, zbaton dhe ruan një regjim të përshtatshëm të mbrojtjes fizike, të zbatueshëm për materialin dhe impiantet bërthamore sipas juridiksionit të vet, me synimin e:

a) mbrojtjes kundër vjedhjes dhe marrjes në formë tjetër të paligjshme të materialit bërthamor në përdorim, ruajtje dhe transport;

b) garantimit të zbatimit të masave të shpejta dhe gjithëpërfshirëse për të lokalizuar dhe, sipas rastit, për të rigjeneruar materialin e humbur ose të vjedhur bërthamor; kur materiali ndodhet jashtë territorit të tij, ai shtet palë do të veprojë në përputhje me nenin 5;

c) mbrojtjes së materialit dhe impianteve bërthamore kundër sabotazhit; dhe

d) lehtësimit ose minimizimit të pasojave radiologjike të sabotazhit.

2. Në zbatim të paragrafit 1, secili shtet palë:

a) krijon dhe ruan një kuadër legjislativ dhe rregullator për rregullimin e mbrojtjes fizike;

b) krijon ose cakton një autoritet kompetent ose autoritete përgjegjëse për zbatimin e kuadrit legjislativ dhe rregullator; dhe

c) merr masa të tjera përkatëse të nevojshme për mbrojtjen fizike të materialit dhe impianteve bërthamore.

3. Në përmbushjen e detyrimeve sipas paragrafëve 1 dhe 2, çdo shtet palë, pa cenuar dispozitat e tjera të kësaj Konvente, zbaton në masën që është e arsyeshme dhe e mundur, parimet e mëposhtme themelore të mbrojtjes fizike të materialeve dhe impianteve bërthamore.

Parimi themelor A: Përgjegjësia e shtetit

Përgjegjësia për krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një regjimi të mbrojtjes fizike brenda një shteti i përket tërësisht atij shteti.

Parimi themelor B: Përgjegjësitë gjatë një transporti ndërkombëtar

Përgjegjësia e një shteti për të garantuar se materiali bërthamor është mbrojtur në nivel të mjaftueshëm, shtrihet për transportin e tij ndërkombëtar derisa ajo përgjegjësi t'i transferohet siç duhet një shteti tjetër, sipas rastit.



Parimi themelor C: Kuadri legjislativ dhe rregullator

Shteti është përgjegjës për krijimin dhe ruajtjen e një kuadri legjislativ dhe rregullator për rregullimin e mbrojtjes fizike. Ky kuadër duhet të parashikojë vendosjen e kërkesave të zbatueshme të mbrojtjes fizike dhe përfshin një sistem vlerësimi dhe licencimi ose procedura të tjera për dhënien e autorizimit. Ky kuadër duhet të përfshijë një sistem inspektimi të impianteve bërthamore dhe transportit, për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat dhe kushtet e zbatueshme të licencës ose një dokumenti tjetër autorizues, dhe për të vendosur një mjet për zbatimin e kërkesave dhe kushteve të zbatueshme, duke përfshirë sanksione efektive.

Parimi themelor D: Autoriteti kompetent

Shteti duhet të vendosë ose caktojë një autoritet kompetent që është përgjegjës për zbatimin e kuadrit legjislativ dhe rregullator, dhe i jepet autoritet i mjaftueshëm, kompetencë dhe burime financiare dhe njerëzore për përmbushjen e përgjegjësisë së tij të caktuara. Shteti duhet të marrë hapa për të garantuar pavarësi efektive midis funksioneve të autoritetit kompetent të shtetit dhe atyre të një organi tjetër të ngarkuar për promovimin ose shfrytëzimin e energjisë bërthamore.

Parimi themelor E: Përgjegjësia e mbajtësve të licencave

Përgjegjësitë për zbatimin e elementëve të ndryshëm të mbrojtjes fizike brenda një shteti duhet të identifikohen qartë. Shteti duhet të garantojë se përgjegjësia parësore për zbatimin e mbrojtjes fizike të materialeve ose impianteve bërthamore i përket mbajtësve të licencave përkatëse ose të dokumenteve të tjera autorizuese (për shembull, operatorët ose transportuesit e mallrave).

Parimi themelor F: Kultura e sigurisë

Të gjitha organizatat e përfshira në zbatimin e mbrojtjes fizike duhet t'i japin prioritetin e duhur kulturës së sigurisë, zhvillimit dhe ruajtjes së saj të nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv në të gjithë organizatën.

Parimi themelor G: Kërcënimi

Mbrojtja fizike e shtetit duhet të bazohet në vlerësimin aktual të kërcënimit nga ana e shtetit.

Parimi themelor H: Qasja e shkallëzuar

Kërkesat e mbrojtjes fizike duhet të bazohen në një qasje të shkallëzuar, duke marrë parasysh vlerësimin aktual të kërcënimit, tërheqjen përkatëse, natyrën e materialit dhe pasojat e mundshme të shoqëruara me eliminimin e paautorizuar të materialit bërthamor dhe me sabotazhin kundër materialeve ose impianteve bërthamore.

Parimi themelor I: Mbrojtja në thellësi

Kërkesat e shtetit për mbrojtjen fizike duhet të reflektojnë një koncept të disa shtresave dhe metodave të mbrojtjes (strukturore ose koncept tjetër teknik, i personelit dhe organizativ) që duhet të zgjidhen ose shmangen nga një kundërshtar, me qëllim arritjen e objektivave të tij.

Parimi themelor J: Garantimi i cilësisë

Një politikë e garantimit të cilësisë dhe programet e garantimit të cilësisë duhet të krijohen dhe zbatohen, me synimin e ofrimit të garancisë se kërkesat e specifikuar për të gjitha veprimtaritë për mbrojtje fizike janë përmbushur.

Parimi themelor K: Planet për rastet e paparashikuara

Planet për rastet e paparashikuara (emergjenca) për reagimin ndaj eliminimit të paautorizuar të materialit bërthamor ose sabotazhit të impianteve ose materialeve bërthamore, ose përpjekjet e tyre, duhet të përgatiten dhe ushtrohen siç duhet nga të gjithë mbajtësit e licencave dhe autoritetet përkatëse.

Parimi themelor L: Konfidencialiteti

Shteti duhet të vendosë kërkesa për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të cenonte mbrojtjen fizike të materialeve dhe impianteve bërthamore.

4. a) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për materiale bërthamore që shteti palë mund të vendosë se nuk është e nevojshme t'i nënshtrohen regjimit të mbrojtjes fizike të vendosur sipas paragrafit 1, duke marrë parasysh natyrën e materialit, sasinë dhe tërheqjen e tij përkatëse dhe pasojat e mundshme radiologjike, si dhe pasojat e tjera të shoqëruara me çdo akt të paautorizuar të drejtuar kundër tij dhe vlerësimin aktual të kërcënimit kundër tij.

b) Materiali bërthamor që nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij neni sipas nënparagrafit (a) duhet të mbrohet në përputhje me praktikën e menaxhimit të kujdesshëm.”.

7. Neni 5 i Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1. Shtetet palë identifikojnë dhe informojnë njëra-tjetrën drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë së Energjisë Atomike mbi pikën e tyre të kontaktit në lidhje me çështje brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente.

2. Në rastin e vjedhjes, grabitjes ose marrjes tjetër të paligjshme të materialit bërthamor ose kërcënimi nga burime të besueshme të tij, shtetet palë, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, do të ofrojnë bashkëpunim dhe ndihmë në masën maksimale të mundshme për rigjenerimin dhe mbrojtjen e këtij materiali për çdo shtet që e kërkon këtë. Në veçanti:

a) një shtet palë merr hapat e nevojshëm për të informuar sa më shpejt që të jetë e mundur shtetet e tjera, që sipas tij mund të kenë interes, në lidhje me çdo vjedhje, grabitje ose marrje tjetër të paligjshme të materialit bërthamor ose kërcënimi nga burime të besueshme të tij dhe për të informuar, sipas rastit, Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizata të tjera përkatëse ndërkombëtare;

b) për këtë, sipas rastit, shtetet palë përkatëse shkëmbejnë informacion me njëra-tjetrën, Energjinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizata të tjera përkatëse ndërkombëtare, me synim mbrojtjen e materialit të rrezikuar bërthamor duke verifikuar integritetin e kontejnerit transportues ose duke rigjeneruar materialin bërthamor të siguruar në mënyrë të paligjshme dhe:

i) bashkërendojnë përpjekjet e tyre nëpërmjet rrugëve diplomatike dhe rrugëve të tjera;

ii) ofrojnë ndihmë, nëse kërkohet;

iii) garantojnë kthimin e materialit bërthamor të rigjeneruar, të vjedhur ose të humbur si pasojë e rasteve të lartpërmendura.

Mjetet e zbatimit të këtij bashkëpunimi përcaktohen nga shtetet palë përkatëse.

3. Në rastin e një kërcënimi të mundshëm, sabotazhi të materialit ose impiantit bërthamor ose në rastin e sabotazhit të tyre, shtetet palë, në masën maksimale të mundshme, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas të drejtës ndërkombëtare, bashkëpunojnë si më poshtë:

a) nëse një shtet palë është në dijeni të një kërcënimi të mundshëm sabotazhi të materialit ose një impianti bërthamor në një shtet tjetër, shteti palë do të vendosë për hapat e nevojshëm që duhet të merren për të informuar atë shtet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, sipas rastit, Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizatat e tjera përkatëse ndërkombëtare për atë kërcënim, me synim parandalimin e sabotazhit;

b) në rastin e sabotazhit të materialit ose impiantit bërthamor në një shtet palë dhe nëse sipas mendimit të tyre, shtetet e tjera mund të cenohen nga pikëpamja radiologjike, shteti palë, pa cenuar detyrimet e tij të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, do të marrë hapat e nevojshëm për të informuar sa më shpejt që të jetë e mundur shtetin ose shtetet që mund të cenohen nga pikëpamja radiologjike dhe duhet të informojë, sipas rastit, Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizatat e tjera përkatëse ndërkombëtare, me synim minimizimin ose lehtësimin e pasojave të tyre radiologjike;

c) nëse në kontekstin e nënparagrafëve (a) dhe (b), një shtet palë kërkon ndihmë, secili shtet palë të cilit i drejtohet një kërkesë për ndihmë, do të vendosë menjëherë dhe do të njoftojë shtetin palë kërkues drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, nëse është i aftë të ofrojë ndihmën e kërkuar dhe fushën e veprimit, si dhe kushtet e ndihmës që mund të ofrohet;

d) bashkërendimi i bashkëpunimit sipas nënparagrafëve (a) deri (c) do të bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike ose rrugëve të tjera të rëna dakord. Mjeti i zbatimit të këtij bashkëpunimi përcaktohet në nivel dypalësh ose shumëpalësh nga shtetet palë përkatëse.

4. Shtetet palë bashkëpunojnë dhe konsultohen, sipas rastit, me njëra-tjetrën drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizatat e tjera ndërkombëtare përkatëse, me synim që të orientohen mbi projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes fizike të materialeve bërthamore në transportin ndërkombëtar.

5. Një shtet palë mund të konsultohet dhe bashkëpunojë, sipas rastit, me shtete të tjera palë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe organizata të tjera



përkatëse ndërkombëtare, me synim që të udhëzohen mbi projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të tij kombëtar të mbrojtjes fizike të materialeve bërthamore për përdorim të brendshëm, ruajtje dhe transport dhe të impianteve bërthamore.”.

8. Neni 6 i Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1. Shtetet palë marrin masat e nevojshme në përputhje me ligjin e tyre kombëtar për mbrojtjen e konfidencialitetit të çdo informacioni që ata marrin në mirëbesim, në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, nga një shtet tjetër palë ose nëpërmjet pjesëmarrjes në një veprimtari të kryer për zbatimin e kësaj Konvente. Nëse shtetet palë i ofrojnë informacion organizatave ndërkombëtare ose shteteve që nuk janë palë të kësaj Konvente në mirëbesim, do të merren hapa për të garantuar mbrojtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni. Një shtet palë që ka marrë informacion në mirëbesim nga një shtet tjetër palë mund t’ia ofrojë këtë informacion palëve të treta vetëm me pëlqimin e atij shteti tjetër palë.

2. Shteteve palë nuk u kërkohet nga kjo Konventë të japin informacion që atyre nuk u lejohet të komunikojnë sipas ligjit kombëtar ose që do të rrezikonte sigurinë e shtetit përkatës ose mbrojtjen fizike të materialeve ose impianteve bërthamore.”.

9. Paragrafi 1 i nenit 7 të Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1. Kryerja e qëllimshme e:

a) një akti pa autoritet të ligjshëm, që përbën marrjen, zotërimin, përdorimin, transferimin, ndryshimin, asgjësimin ose shpërhapjen e materialit bërthamor dhe që shkakton ose mund të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të një personi ose dëm të konsiderueshëm ndaj pronës ose mjedisit;

b) një vjedhjeje ose grabitjeje të një materiali bërthamor;

c) një përvetësimi ose marrjeje të materialit bërthamor me anë të mashtrimit;

d) një veprim që përbën transportimin, dërgimin ose zhvendosjen e materialit bërthamor në ose jashtë një shteti, pa autoritet të ligjshëm;

e) një akti të drejtuar kundër një impianti bërthamor ose një akti që ndërhyr në operimin e një impianti bërthamor, nëse shkelësi shkakton qëllimisht ose nëse është në dijeni se akti mund të shkaktojë vdekje ose plagosje të rëndë të një personi ose dëm të konsiderueshëm ndaj pronës ose mjedisit nga ekspozimi ndaj rrezatimit ose çlirimit të substancave radioaktive, nëse akti nuk ndërmerret në përputhje me ligjin kombëtar të shtetit palë, në territorin në të cilin ndodhet impianti bërthamor;

f) një akti që përbën kërkesë për materiale bërthamore me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose me formë tjetër kërcënimi;

g) një kërcënim:

i) për të përdorur material bërthamor për të shkakuar vdekjen ose plagosjen e rëndë të një personi ose dëm të konsiderueshëm ndaj pronës ose mjedisit, ose për të kryer veprën penale të përcaktuar në nënparagrafin (e); ose

ii) për të kryer një veprë penale të përcaktuar në nënparagrafët (b) dhe (e), me qëllim që të detyrojë një person fizik ose juridik, organizatë ndërkombëtare ose shtet të kryejnë ose të mos kryejnë ndonjë akt;

h) një tentativë për të kryer një veprë penale të përcaktuar në nënparagrafët (a) deri (e);

i) një akt që përbën pjesëmarrje në një veprë penale të përcaktuar në nënparagrafët (a) deri (h);

j) një akti të ndonjë personi që organizon ose drejton të tjerët për të kryer një veprë penale të përshkruar në nënparagrafët (a) deri (h); dhe

k) një akti që kontribuon në kryerjen e një veprë penale të përcaktuar në nënparagrafët: a) deri (h) nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët; ky akt do të jetë i qëllimshëm dhe ose:

i) do të bëhet me synim vazhdimin e veprimtarisë ose qëllimit kriminal të grupit, nëse ky aktivitet ose qëllim përfshin kryerjen e një veprë penale të përcaktuar në nënparagrafët (a) deri (g); ose

ii) do të bëhet duke pasur njohuri për synimin e grupit për të kryer një veprë penale të përshkruar në nënparagrafët (a) deri (g);

do të bëhet veprë penale e dënueshme nga secili shtet palë sipas ligjit të tij kombëtar.”.

10. Pas nenit 11 të Konventës shtohen dy nene të reja, neni 11A dhe neni 11B, me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 11A

Asnjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 7 nuk konsiderohet, për qëllimet e ekstradimit ose ndihmës së ndërsjellë juridike, si vepër penale politike ose si vepër penale e lidhur me një vepër penale politike ose si vepër penale e frymëzuar nga motive politike. Rrjedhimisht, një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë të ndërsjellë juridike të bazuar në këtë vepër penale nuk mund të refuzohet për arsyen e vetme se ka lidhje me një vepër penale politike ose një vepër penale të lidhur me një vepër penale politike ose një vepër penale të frymëzuar nga motive politike.

Neni 11B

Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur vendos një detyrim për ekstradimin ose dhënien e ndihmës së ndërsjellë juridike, nëse shteti palë i kërkuar ka arsye thelbësore për të besuar se kërkesa për ekstradim për veprat penale të përcaktuara në nenin 7 ose për ndihmë të ndërsjellë juridike në lidhje me këto vepra penale, është bërë për qëllimin e ndjekjes penale ose dënimit e një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose opinionit politik të atij personi ose që përputhshmëria me kërkesën do të cenonte pozicionin e atij personi në bazë të ndonjë prej këtyre arsyeve.”.

11. Pas nenit 13 të Konventës shtohet neni i ri 13A me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 13A

Asgjë në këtë Konventë nuk cenon transferimin e teknologjisë bërthamore për qëllime paqësore që ndërmerret për të forcuar mbrojtjen fizike të materialeve dhe impianteve bërthamore.”.

12. Paragrafi 3 i nenit 14 të Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“3. Nëse një vepër penale përfshin një material bërthamor në përdorim shtëpiak, ruajtje ose transport dhe shkelësi i dyshuar dhe materiali bërthamor mbeten në territorin e shtetit palë në të cilin është kryer vepra penale ose nëse një vepër penale përfshin një impiant bërthamor dhe shkelësi i dyshuar mbetet në territorin e shtetit palë në të cilin është kryer vepra penale, asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur i kërkon atij shteti palë të japë informacion në lidhje me një procedim penal që rezulton nga kjo vepër penale.”.

13. Neni 16 i Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“1. Një konferencë e shteteve palë thirret nga depozitari pesë vjet pas hyrjes në fuqi të amendamentit të miratuar më 8 korrik 2005 për rishikimin e zbatimit të kësaj Konvente dhe mjaftueshmërisë së saj në lidhje me preambulën, tërësinë e pjesës operacionale dhe shtojcat, duke marrë në konsideratë situatën mbizotëruese të asaj kohe.

2. Në interval kohor prej jo më pak se pesë vjet më pas, shumica e shteteve palë mund të sigurojnë, duke i paraqitur depozitarit një propozim për këtë qëllim, thirrjen e konferencave të mëtejshme me të njëjtin objektiv.”.

14. Shënimi fundor b/i shtojcës II të Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“b) Materiali që nuk rrezatohet në një reaktor ose materiali i rrezatuar në një reaktor, por me nivel rrezatimi të barabartë ose më pak se 1 grej/orë (100 rada/orë) në një metër të pambrojtur.”.

15. Shënimi fundor e/ i shtojcës II të Konventës zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“e) Një lëndë tjetër djegëse që në bazë të përmbajtjes së saj origjinale të materialit të zbërthyeshëm, klasifikohet si kategoria I dhe II përpara rrezatimit, mund të reduktohet një nivel kategorie, ndërsa niveli i rrezatimit nga lëndë djegëse kalon 1 grej/orë (100 rada/orë) në një metër të pambrojtur.”.



UDHËZIM
Nr. 2, datë 27.2.2013

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË MBROJTJES
SOCIALE PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (të ndryshuar), ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, si dhe pikës 29/c të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”,

UDHËZOJ:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2013, fondet e akorduara në programin “Mbrojtja sociale”, si transfertë e kushtëzuar, i shpërndan në mënyrë periodike, për:

a) Pagesën e dëmshpërblimit të të dënuarve politikë, e cila do të përdoret sipas pikës 21 dhe 22 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”.

b) Pagesën për programin e ndihmës ekonomike.

c) Pagesën për programin e personave me aftësi të kufizuara.

d) Financimin e bashkive për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore, që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore.

2. Për vlerësimin e projekteve të paraqitura dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, krijohet një komision me 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga Ministri dhe anëtarët janë: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit të Ministrit, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit, Analizës dhe Statistikës, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Komisioni mblidhet periodikisht dhe vlerëson projektet e paraqitura që vijnë nga ana e njësisë së qeverisjes vendore dhe vendos nivelin e financimit.

4. Njësitë e qeverisjes vendore paraqesin projektet dhe nivelin e financimit për financimin nga fondet e mbrojtjes sociale, sipas gurmës “d” të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social.

5. Këshillat e njësisë së qeverisjes vendore të përcaktojnë kontributin e tyre sipas mundësive financiare.

6. Njësitë e qeverisjes vendore, për mbështetje financiare, sipas gurmës “d” të pikës 1, paraqesin një informacion mbi gjendjen aktuale të ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore, për të cilën kanë paraqitur projekt.

7. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e dokumentacionit dhe kërkesave të paraqitura nga njësia e qeverisjes vendore, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, vlerëson prioritetin e projektit, si dhe nivelin e financimit. Vlerësimi të bëhet pas verifikimit mbi gjendjen aktuale të ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore.

8. Nëse projekti dhe kërkesa e paraqitur nga njësia e qeverisjes vendore është i plotë, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e nivelit të financimit dhe të gjendjes aktuale të ambienteve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve në qendrat e pakujdesjes shoqërore.

9. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, vlerësimin e bërë me shkrim, sipas pikës 6 dhe 7 të këtij udhëzimi, së bashku me projektin dhe kërkesën e paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore për financimin e mirëmbajtjes së ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore, i përcjell në MPCSSHB.

10. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale, dosjen e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, sipas pikës 4 dhe 7 të këtij udhëzimi, e verifikon plotësimin e saj dhe e përcjell në komisionin e ngritur, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, duke informuar me shkrim për çdo projekt që do të financohet.

11. Komisioni me marrjen e informacionit nga Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale përcakton vlerën përfundimtare të financimit.

12. Komisioni për përcaktimin e financimit të mirëmbajtjes së ambienteve të qendrave të përkujdesjes sociale do të marrë në konsideratë edhe orientimet e Avokatit të Popullit, si dhe sugjerimet e subjekteve jopublike, të specializuara në këto shërbime.

13. Fondi i miratuar nga komisioni, për mbështetje sipas germave “d” të pikës 1 të këtij udhëzimi, delegohet si transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore nga MPCSSHJ-ja, së bashku me një kopje të vendimit të komisionit.

14. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të këtij fondi.

15. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre fondeve, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore merr vendim për përdorimin e këtij fondi, për qëllimin që është dhënë, së bashku me kontributin e saj.

17. Për raportimin e realizimit të përdorimit të fondit, si dhe kontrollin e përdorimit të tyre, të ndiqet e njëjta procedurë, si vepohet për fondet buxhetore në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 2/1, datë 15.2.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM

Nr. 2, datë 6.3.2013

PËR KËRKESAT TEKNIKE TË CAKTIMIT TË NGASTRAVE, GRUP-NGASTRAVE DHE EKONOMIVE PYJORE PËR TRAJTIME, MIRËMBAJTJE E PRERJE RIPËRTËRITËSE, RREGULLAT PËR VJELJEN E MATERIALIT DRUSOR DHE SHITJEN ME ANKAND TË LËNDËS DRUSORE E TË PRODHIMEVE TË TJERA DRUSORE E JODRUSORE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 27 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të pikës IV/8 dhe të pikës 1/10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 21.6.2006 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera, drusore e jodrusore”,

UDHËZOJ:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Trajtimet dhe prerjet ripërtëritëse në fondin pyjor publik janë veprimtari që përgatiten nga drejtoritë e shërbimit pyjor, si autoriteti përgjegjës për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor



rajonal, duke përcaktuar masa teknike, teknologjike e financiare, që mundësojnë realizimin e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

2. Hedhja e ngastrave në ankand për trajtimin e grumbujve pyjore do të bëhet me ekonomi pyjore, me lote. Vetëm në rastet e domosdoshme të ndërhyrjeve dhe kur nuk ka mundësi të krijohen grup ngastrash, do të bëhet me ngastër të veçantë.

3. Ankandi do të zhvillohet pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) nga Komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit, për rastet kur:

a) Kërkohej trajtimi i ngastrave/grup-ngastrave/ekonomive pyjore pa rrugë autopsyjore;

b) Kërkohej trajtimi ngastrave/grup-ngastrave me punime silvikulturore (pastrime, rrallime, preje higjieno-sanitare) në nivel ekonomie pyjore.

4. Ankandi do të zhvillohet në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, nga Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit:

a) Në rastet kur kërkohej trajtimi i ngastrave/grup-ngastrave pyjore, me rrugë autopsyjore;

b) Në rastet e sekuestrimeve të lëndës drusore;

c) Në raste të tjera që nuk janë parashikuar në këtë udhëzim;

d) Në rastin e prodhimeve jodrusore.

5. Me kompaninë që shpallet fitues nga ankandi apo nga tenderimi për trajtimin e fondit pyjor dhe vjeljen e prodhimeve drunore e jodrunore, lidhet kontrata. Ajo firmoset nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kompania fituese, për rastet kur ankandi zhvillohet në MMPAU dhe nga Drejtori i Shërbimit Pyjor, në rastet kur ankandi zhvillohet në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor. Kontrata përpilohet në katër kopje, nga të cilat dy qëndrojnë në MMPAU/DSHP sektorin e menaxhimit e trajtimeve dhe financës, një në shërbimin pyjor, kurse e katërta i jepet kompanisë.

6. Në kontratë pasqyrohen vëllimet e lëndës drusore në këmbë sipas llojeve dhe asortimenteve, që do të prodhohen për çdo ngastër pyjore, datat e fillimit e përfundimit të prerjes, nxjerrjes e stivimit të materialit drusor në anë të rrugës dhe të kolaudimit të ngastrave/nënngastrave.

7. Përpara lidhjes së kontratës, kompania kontrollon në vend dhe u paraqet me shkrim organeve pyjore vërejtjet që mund të ketë për sasinë e vëllimit drusor në këmbë që do të vjelë. DSHP-ja me komision verifikon vërejtjet dhe kur këto janë me vend, bën ndryshimet përkatëse. Në komisionin e vlerësimit duhet të marrë pjesë domosdoshmërisht specialisti i damkimit të ngastrës, pas kësaj, Drejtoria e Shërbimit Pyjor nuk mban asnjë përgjegjësi për sasinë dhe cilësinë e lëndës drusore të shitur në këmbë dhe kompanisë nuk i lind asnjë e drejtë ankimi për diferencat që mund të ketë në fund të proceseve të punës.

8. Pas nënshkrimit të kontratës, DSHP-ja i jep kompanisë lejen e shfrytëzimit, në të cilën shënohen ngastra/nënngastra, sasia dhe lloji i lëndës drusore dhe asortimentet që do të prodhohen, si dhe datat e fillimit dhe të përfundimit të shfrytëzimit. Leja përpilohet në tri kopje, nga të cilat një i jepet kompanisë, një sektorit pyjor dhe një qëndron në seksionin e administrim-menaxhimit.

9. Kompania është e detyruar të respektojë fazat e përcaktuara në projektin tekniko-organizativ dhe t'i përgjigjet kërkesave periodike të shërbimit dhe policisë pyjore për deklarimin vullnetar, monitorimeve dhe auditimeve të parashikuar në kontratë apo të rasteve specifike, kur këto kërkohej.

10. Trajtimet dhe vjelja e materialit drusor fillon pasi është hartuar projekti tekniko-organizativ i trajtimit, lidhur kontrata, është marrë në dorëzim me procesverbal fondi pyjor përkatës dhe është pajisur me lejen përkatëse të trajtimit nga DSHP-ja ose certifikatën nga organizata të specializuara për certifikim.

11. Sektori pyjor lejon kompaninë të kryejë aktivitetet e trajtimit, vjeljes dhe transportin e brendshëm të materialit drusor, vetëm në atë ekonomi pyjore/pjesët e ekonomisë pyjore për të cilën është dhënë leja përkatëse. Kompania është e detyruar të vjelë vetëm vëllimin drusor, që është damkosur dhe cilësuar në lejen e shfrytëzimit.

12. Kompanitë që vjelin material drusor dhe prodhime të dyta pyjore në ekonomitë/pjesë të tyre, të marra për trajtime me prerje ripërtëritëse dhe për kohën e kontraktuar, mbajnë përgjegjësi të plotë për dëmet që shkaktohen në ekonominë pyjore ku punojnë, nëse nuk denoncojnë në organet kompetente.

13. Me marrjen në dorëzim të pjesës/ekonomisë pyjore, kompania zbaton:

a) kërkesat e specifikuara në lejet e shfrytëzimit;

b) detyrimet e përcaktuara në kontratën që ka lidhur me MMPAU/DSHP, sipas rastit;
c) kërkesat ligjërish të bazuara të deklarimeve vullnetare, kontrolleve e kolaudimeve të ushtruara gjatë periudhës së kryerjes së punimeve.

14. DSHP-ja ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi veprimtarinë e kompanisë që ushtron aktivitete trajtimesth e prerje ripërtëritëse në pyll dhe urdhëron riparimin e të metave që vëren.

15. Plotësimi i nevojave vetjake të familjeve me banim të përhershëm në njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) që nuk iu janë transferuar në pronësi/përdorim pyje komunale, me dru zjarri e lëndë ndërtimi, përmbushet nga pyjet shtetërore, brenda territorit të NJQV-ve, nëpërmjet mbledhjes (vlerësimit) së lëndës drusore nga drurët e rrëzuar (shkulur e thyer), nga furtunat e zjarret dhe punimet e trajtimit rehabilitues të pyllit me rrallime e prerje sanitare. Për plotësimin e nevojave të familjeve, hartohet lista në bazë fshati nga kryeplaku/kryetari i NJQV-ve, miratohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor dhe pas pagesës, sipas tarifave përkatëse në fuqi, bëhet plotësimi i nevojave.

16. Të gjitha kriteret teknike të vendosura më lart për trajtimet silvikulturore dhe ripërtëritëse, sipas këtij udhëzimi, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në rastin e pyjeve private dhe komunale.

KREU II

CAKTIMI I NGASTRAVE E GRUP-NGASTRAVE PËR TRAJTIME E PRERJE RIPËRTËRITËSE

1. DSHP-të, në muajin prill, kryejnë studimin e ngastrave/nënngastrave që do të trajtohen me prerje të lejuara për vitin pasardhës.

2. Studimi bëhet në përputhje me mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve, të përcaktuara në planet e mbarështimit apo inventarizimit, gjendjen ekzistuese të ngastrave/grup ngastrave/ekonomisë pyjore në terren dhe azhurnimit të bërë vitin e fundit. Në të përshkruhet:

- a) numri i ngastrave apo nënngastrave;
- b) vëllimi i lëndës së punimit dhe druve të zjarrit që do të shfrytëzohet në çdo ngastër;
- c) periudha e vënies në shfrytëzim të çdo grup-/ngastre/nënngastre.

3. Studimi i përfunduar dërgohet për miratim në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

4. Dorëzimi i ekonomisë pyjore ose pjesëve të saj për trajtim apo prerje ripërtëritëse bëhet me pjesë sipas projektit teknologjik të shfrytëzimit. Për çdo dorëzim mbahet procesverballi i kolaudimit provizor dhe në fund ai përfundimtar.

5. Pjesë të ekonomisë pyjore që janë të palidhura me rrjetin rrugor autopsyjor ekzistues dhe për të cilat shprehet interes nga kompanitë private të licencuara për trajtimin e prerjet ripërtëritëse në pyjeve, duke sipërmarrë ndërtimin e tyre, përfshihen në studimin paraprak dhe miratohen nga Ministri, veçmas në përmbledhësen e shitjes me ankand të lëndës drusore në këmbë, në një pasqyrë të veçantë. Miratimi i kësaj përmbledhëseje bëhet njëlloj si për ngastrat e lidhura me rrugë autopsyjore.

6. Ekonomi pyjore që janë të papajisura me plane mbarështimi dhe për të cilat shprehet interes nga kompanitë private të licencuara për operacione në pyje (trajtime silvikulturale), duke sipërmarrë hartimin e tyre, përfshihen në studimin paraprak dhe miratohen nga Ministri. Operacionet pyjore kryhen vetëm pas miratimit të planit të mbarështimit dhe vlera e tij kompensohet.

7. Kompanitë private kanë të drejtë të përzgjedhin me procedura konkurrimi subjekte të specializuara për hartimin e planeve të mbarështimit, nga lista e hartuar nga DPK-ja.

KREU III

RREGULLAT E DAMKOSJES

1. Prerja e drurëve në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë të veçantë nga DSHP-të, nëpërmjet specialistëve të lartë të pyjeve (dega silvikulturë, i përgjithshëm, shfrytëzim dhe mbarështim-shfrytëzim).

2. Madhësia e çekiç-damkës me gjithë bisht është 30-50 cm e gjatë dhe me peshë të pjesës metalike nga 700-900 gramë. Ajo ka formën e një sëpate të vogël, ku në anën e përparme të saj është



tehu prerës, i cili shërben për heqjen e lëvores së drurëve që do të damkosen dhe në anën e pasme ka shenjën e saj, ku janë vendosur e kombinuar germat dhe numrat përkatës. Çdo germe i përkasin 10 numra, duke filluar nga numri 0 deri te numri 9. Germës A i takon numri A0 deri në A9 dhe kështu me radhë për germat e tjera: B, C, D, E, F, G, K, H, I, L, M dhe N.

3. Para procesit të damkimit, DSHP-ja bën testimin e kërkesave të tregut, sipas nevojave dhe asortimenteve drusore, për të përcaktuar vëllimin paraprak që do të damkoset.

4. Drejtori i DSHP-së, para datës 15 maj, nxjerr urdhrin me shkrim për organizimin e procesit të damkimit. Në urdhër përcaktohen datat e fillimit dhe të mbarimit të këtij procesi, specialistët e damkimit dhe ngastrat/nënngastrat ku do të damkosë secili prej tyre. Nuk lejohet që dy apo disa specialistë të damkosin në të njëjtën ngastër apo nënngastër pyjore.

5. Drurët shënohen me çekiç-damkë në pjesën e poshtme të tyre, sa më afër sipërfaqes së tokës. Krahas damkës, në lartësinë 1.5 m, drurit i bëhet një shenjë, duke hequr një pjesë të lëvores me sëpatë. Damka dhe shenja vendosen në shpat nga lart-poshtë.

6. Shënimi i drurëve me damkë, si rregull, fillon në datën 15 maj dhe përfundon në datën 30 qershor.

7. Gjatë procesit të damkimit, për secilën pjesë e brez, specialisti i damkimit mban shënim kategoritë diametrike për çdo lloj drusor, të cilat i bashkëngjiten listëdamkës. Ai mban përgjegjësi për numrin e drurëve të damkosur, kategoritë e tyre diametrike, klasën e lartësisë dhe vëllimin drusor që rezulton pas damkimit.

8. Me përfundimin e procesit të damkimit, seksioni i administrim-menaxhimit:

a) bën përpilimin e listë-damkave, në katër kopje, për çdo ngastër/nënngastër pyjore e sipas llojeve drusore, të cilat firmosen nga specialisti që ka kryer damkimin;

b) përllogarit vëllimin drusor që do të vilet nga secila ngastër/nënngastër. Kur ky vëllim del i ndryshëm nga parashikimet që janë bërë në planet e mbarështimit apo të inventarizimit, DSHP-ja me shkrim i kërkon Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave të bëjë miratimin dhe korrigjimin e shifrave të planeve, duke i përputhur me vëllimet faktike.

9. Pas procesit të damkimit, kompanitë private të interesuara kryejnë studimin dhe projektimin e mënyrës së shfrytëzimit; piketojnë rrugët e lëvizjes së materialit drusor me krahe e mekanizma, përllogaritin distancat e transportit të brendshëm, caktojnë vendet e grumbullimit dhe stivimit të materialit drusor. Në projektin tekniko-organizativ të trajtimeve dhe prerjeve ripërtëritëse analizohen më shumë se një variant.

10. Ndërtimi dhe kolaudimi i rrugëve autopjore, rrugëve të rrokullisjes, skelave të ngarkimit dhe montimi i teleferikëve bëhen para se të fillojë trajtimi i ngastrës/nënngastrës.

11. Me përfundimin e projektimit të mënyrës së prerjeve ripërtëritëse të ngastrave, nga kompanitë private bëhet:

a) hartimi i projekteve teknologjike të shfrytëzimit, kur trajtimi dhe shitja e materialit drusor bëhet me ankand, në këmbë (i paprerë);

b) hartimi i projekteve tekniko-ekonomike të shfrytëzimit, kur trajtimi dhe prodhimi i asortimenteve të gatshme në anë të rrugës realizohen nga kompani të përzgjedhura, nëpërmjet tenderëve dhe shitja e tyre bëhet me ankand, në anë të rrugës apo sheshet e depozitimit.

12. Projektet e germave “a” dhe “b” të pikës 11 të këtij udhëzimi miratohen me komision nga DSHP-ja.

13. Projekti teknologjik dhe tekniko-ekonomik i trajtimit dhe prerjeve ripërtëritëse përpilohet në tri kopje, nga të cilat një i jepet sektorit pyjor, një kompanie fituese të punimeve të trajtimit të pjesë-/ekonomisë pyjore dhe një ruhet në seksionin e administrim-menaxhimit, së bashku me dokumentet e ankandit apo tenderit.

Ndalohet fillimi i punimeve për prerjen e materialit drusor pa miratuar projektin teknologjik dhe tekniko-ekonomik të trajtimit/prerjeve ripërtëritëse të grup-/ngastrës apo nënngastrës pyjore.

14. Caktimi i ngastrave për t'u përshkuar me prerje ripërtëritëse/trajtime, shënimi i drurëve me damkë dhe matja e tyre, përpilimi i listëdamkave dhe hartimi i projektit teknologjik dhe tekniko-ekonomik të trajtimeve për secilën ngastër pyjore, së bashku me fondet që nevojiten për prodhimin e

asortimenteve drusore, që dalin nga prerja e drurëve në këmbë, bëhet deri më 30 korrik të vitit paraardhës.

15. Pasqyra përmbledhëse e ngastrave me prerje të lejuara të damkosura, për lëndën drusore në këmbë (e paprerë), që do të nxirret për shitje me ankand, miratohet nga Ministri, brenda datave 15 gusht dhe 25 shkurt të vitit pasardhës. Së bashku me përmbledhësen dërgohen në drejtorinë përkatëse teknike në ministri dhe një kopje e listëdamkës dhe projektit teknologjik të shfrytëzimit. Diferencat e lejuara ndërmjet vëllimit të ngastrës në kadastër dhe vëllimit të damkosur, merren të mirëqena kur janë plus-minus 10%.

16. Materiali drusor që rezulton nga hapja e rrugëve të brendshme e transportit të brendshëm dhe ai i rrëzuar e dëmtuar nga shkaqe natyrore, vlerësohet dhe përfshihet në sasinë e materialit drusor të damkosur, të dhënë për shfrytëzim.

17. Për të siguruar ripërtëritjen natyrore e të gjitha llojeve të florës (përveç llojeve të ndaluara për grumbullim me një akt të veçantë), drejtoritë e shërbimit pyjor çdo vit përcaktojnë sipërfaqet ku do të ndalohet grumbullimi i tyre për një vit. Këto sipërfaqe nuk mund të jenë më pak se 1/3 e sipërfaqes së fondit total të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere që administrohen nga drejtoria përkatëse dhe emërtohen “sipërfaqe për ripërtëritje”.

18. Përcaktimi i llojeve dhe i sasive të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, që do të grumbullohen në një vit kalendarik, mbështetet në planet përkatëse të inventarizimit të përditësuar, duke iu referuar 10-20 llojeve kryesore të tyre.

19. Nxjerrja dhe grumbullimi nga pylli i prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i boçeve të pishës, i thuprave të shelgut, i frashrit, i vërrinit etj., i rrëshirës së pishës, i kërpudhave dhe i prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, bëhet me ankand nga persona fizikë e juridikë, të cilët pasi shpallen fitues, kontraktojnë me DSHP-në ose me njësinë e qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat sipas formës së përdorimit/pronësisë, si dhe paguajnë tarifën përkatëse.

KREU IV PRERJA DHE ASORTIMI

1. Në pyjet trungishte prerja lejohet gjatë gjithë vitit, kurse në pyjet cungishte dhe shkurret, të cilat ripërtërihen me lastarë, lejohet nga 1 tetori deri më 31 mars të vitit pasardhës. Në rastet e vegetacionit të vonuar, periudha e prerjes zgjatet deri më 15 prill për zonat fushore dhe deri më 30 prill në zonat malore. Në shkurret me mare, prerja lejohet gjatë gjithë vitit.

2. Trajtimi me prerje ripërtëritëse i grup-/ngastrave/nënngastrave pyjore fillon gjithmonë nga lart-poshtë dhe asnjëherë nga poshtë-lart, duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

3. Drurët me diametër deri 15 cm priten rrafsh me sipërfaqen e tokës dhe kur diametri i tyre është mbi trashësinë 15 cm, lartësia e cungjeve mbi sipërfaqen e tokës, nuk duhet të jetë më shumë se 1/3 e diametrit. Gjatë prerjes e rrëzimit të drurëve, rruhet germa e numri i damkës.

4. Pas prerjes me motosharrë, cungjet e llojeve që ripërtërihen me lastarë, laspiten me sëpatë, duke rrafshuar sipërfaqen e sipërme të tyre dhe duke bërë unazimin e buzëve, por pa dëmtuar lëvoren.

5. Drejtimi i rrëzimit të drurëve bëhet në drejtimin e kundërt me atë të lëvizjes dhe zgjidhet i tillë që të mos dëmtohet dhe të mos thyejë e dëmtojë drurët e tjerë në këmbë, të padamkosur dhe filizërinë. Ndalohet rrëzimi i drurit me anën e rrëzimit të një druri tjetër mbi të.

6. Në prerjet e dyta dhe përfundimtare kryhen njëherësh dhe brenda ditës të gjitha operacionet e punës së prodhimit, si: prerja, pastrimi i trungut të drurit nga degët, asortimi sipas dimensioneve të kërkuara, prodhimi i druve të zjarrit, transporti i asortimenteve të prodhuara në anë të rrugës, pastrimi i sipërfaqes dhe grumbullimi i degëzave, duke krijuar vijueshmëri në procesin teknologjik.

7. Kompania që kryen vjeljen e materialit drusor është e detyruar të zbatojë këto rregulla teknike:

- a) të presë vetëm dhe të gjithë drurët e shënuar me damkë;



b) të asortojë të gjithë materialin drusor që është i rrëzuar, i thatë ose i dëmtuar, i vlefshëm për lëndë punimi dhe dru zjarri, si dhe materialin drusor që del nga çelja e rrugëve pyjore brenda ngastrës, pas vlerësimit me procesverbal nga shërbimi pyjor;

c) të ruajë nga dëmtimet drurët që janë të padamkosur, drurët e rinj dhe filizërinë;

d) të transportojë, të rrokullisë e të depozitojë të gjithë materialin drusor vetëm në rrugët dhe vendet e caktuara në projektin e miratuar tekniko-organizativ e teknologjik të trajtimeve/prerjeve ripërtëritëse;

e) të bëjë pastrimin e nxjerrjen jashtë parcelës së kalbësirave dhe mbeturinave (degëzat, lëvoret, bulashkat dhe copat e vogla të drurit);

g) të zbatojë të gjitha rregullat për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret ose dëmtime të tjera, si dhe të gjitha rregullat teknike të vendosura për trajtimin e pyjeve, të cilat specifikohen në procesverbalin e dorëzimit dhe kontratën e lidhur midis palëve;

h) të bëjë evadimin e plotë të materialit drusor nga ngastra, 1 muaj pas mbarimit të afatit të prerjes, të përcaktuar në kontratë.

8. Nxjerrja e rrënjëve të shqopës, bushit dhe maresë bëhet mbasi të jetë kryer studimi i ngastrave e nënngastrave për këtë qëllim, studim që kryhet një vit para. Nxjerrja e rrënjëve do të bëhet uniformisht në të gjithë sipërfaqen e ngastrës/nënngastrës dhe në masën jo më tepër se 30% të saj.

9. Pas nxjerrjes së rrënjëve, kompania fituese prodhon drutë e zjarrit e fashinat që rezultojnë nga shkulja, si dhe mbush gropat me dhe.

KREU V

KËRKESAT TEKNIKE GJATË PRERJEVE TË DYTA E PËRFUNDIMTARE

1. Trajtohen me prerje të dyta e përfundimtare ngastrat e nënngastrat, në të cilat filizëria ka arritur treguesit optimalë, si më poshtë:

a) për pyjet e ahut, kur kanë filizërinë me moshë 6-10 vjet, lartësia e filizave 30-80 cm dhe mbi 3 filiza/m² (ose mbi 30.000 filiza/ha të shpërndarë uniformisht), në mbi 80% të sipërfaqes;

b) për pyjet e pishës së zezë, kur kanë filizërinë me moshë 4-6 vjet, lartësia e filizave 25-50 cm dhe mbi 2-3 filiza/m² (ose mbi 20.000-30.000 filiza/ha të shpërndarë uniformisht), në mbi 80% të sipërfaqes.

2. Në vitet me prodhimit të bollshme fare, prerjet e dyta e përfundimtare planifikohen në sipërfaqe më të mëdha në krahasim me vitet pa ose me prodhim të pakët fare.

3. Kur është siguruar ripërtëritja natyrore dhe filizëria është e papërdorshme, prerjet kryhen gjatë të gjithë vitit, me kusht që filizat e dëmtuar fletorë të priten brenda një kohe sa më të shkurtër pas prerjes së drurëve të rritur, në periudhën e pushimit të vegjetacionit.

4. Kur prerjet e dyta e përfundimtare janë tepër të vonuara, prerja e drurëve kryhen në periudhën e pushimit të vegjetacionit e me dëborë, apo në periudha të tjera të vitit, duke respektuar kërkesat teknike të përfundimit të prerjes së drurëve, numri i filizave gjendje për sipërfaqen e përshkruar me prerje duhet të jetë 3-1 filiza për m². Kur mbi 80% e filizërisë është e padëmtuar, nuk ka nevojë për ndërhyrje me punime; kur është dëmtuar deri në 60%, ndërhyhet me punime për favorizimin e ripërtëritjes dhe kur dëmtimi është më i madh, ndërhyhet me ripyllëzime.

KREU VI

TRANSPORTI I BRENDSHËM

1. Rrugët e transportit të brendshëm të materialit drusor (me krahë dhe traktorë) përgjithësisht caktohen në vende pa filizëri, duke shfrytëzuar sipërfaqet boshe ose të parapërtëritura, si dhe rrugët ekzistuese, siç është parashikuar në projektin tekniko-organizativ të shfrytëzimit.

2. Në ngastrat e nënngastrat me filizëri të rritur, rrugët caktohen mbi bazën e kritereve teknike që sigurojnë dëmtimin minimal të filizërisë.

3. Në vendet me ripërtëritje hapet një minimum rrugësh për lëvizjen e mjeteve ose lëndësh drusore. Distanca midis rrugëve të mos jetë më e vogël se 100 m. Gjerësia e rrugës së traktorit dhe e rrugëve të rrokullisjes të mos kalojë 4 m.

4. Për transportin e materialit drusor me teleferik, lejohet hapja e trasesë me gjerësi sipas tipit të teleferikut.

5. Litarët prej çeliku, që shërbejnë për montimin e teleferikëve apo mekanizmave e pajisjeve të tjera, nuk lejohet të dëmtojnë lëvoren e drurëve në këmbë duke vendosur një unazë gome.

6. Asortimentet e prodhuara transportohen nga vendi i prodhimit deri në anë të rrugës (shesh depozitimi), vetëm në rrugët dhe me instalimet e miratuara në skemën teknologjike të shfrytëzimit të ngastrave/nënngastrave, duke pasur parasysh ruajtjen e tyre nga dëmtimet.

7. Nxjerrja e asortimenteve nga brendësia e sipërfaqes së ngastrës apo nëngastrës, nëpër rrugët e rrokullisjes me krahë apo me traktorë, bëhet krahas prodhimit të tyre.

8. Transportimi i lëndës së punimit të llojit ah, nga brenda ngastrës, nëngastrës deri në anë të rrugës, i prerë prej 1 prillit deri më 30 shtator, nuk duhet të vonohet më shumë se 30 ditë nga koha e prerjes.

9. Kur transporti i materialeve të imëta (dru zjarri etj.) bëhet me kafshë nëpër rrugë të përcaktuara paraprakishtato pajisen me mbrojtëse për të mos dëmtuar filizërinë.

KREU VII PASTRIMI DHE DORËZIMI

1. Pastrimi i sipërfaqeve ku janë kryer prerjet është pjesë e procesit të trajtimit. Ai realizohet krahas procesit të prerjes, duke respektuar ndarjen e ngastrave në pjesë.

2. Krahas prodhimit dhe transportit të brendshëm, kryhet pastrimi i degëve dhe ai natyror, duke i vendosur në togje në largësi 30-40 m larg njëri-tjetrit apo në pjesë të rrezikuara nga erozioni. Në terrere me pjerrësi mbi 25 gradë, grumbullimi i tyre bëhet në formë brezash, në të njëjtin drejtim me izoipset dhe në largësi 30-50 m nga brezi në brez.

3. Pastrimi i pjesëve, ngastrave dhe nëngastrave përfundon deri 30 ditë pas përfundimit të prerjes. Pas pastrimit, pjesa e ngastrës/nënngastrës, merret në dorëzim nga organet pyjore me procesverbal kolaudimi provizor.

4. Në përfundim të pastrimeve për të gjithë ngastrën apo nëngastrën, mbi bazën e procesverbaleve provizore të pjesëve të saj, përpilohet procesverbali përfundimtar i kolaudimit dhe i marrjes në dorëzim nga organet pyjore.

KREU VIII DEPOZITIMI DHE STIVIMI I MATERIALIT DRUSOR

1. Materiali drusor, që rezulton nga trajtimi dhe prerjet ripërtëritëse në pyje, depozitohet dhe stivohet në buzë të ngastrave/nënngastrave pyjore, anës rrugëve autopjore, pa zënë brezin e kalimit ose në sipërfaqe të tjera të përcaktuara nga organet pyjore. Depozitimi i tyre bëhet direkt mbi sipërfaqen e tokës, në vende ku nuk ka filizëri.

2. Depozitimi i materialit drusor bëhet duke e marketuar dhe magazinuar sipas asortimenteve, nga kompania zbatuese e projektit të prerjeve ripërtëritëse apo të trajtimit të pyllit:

a) Trupat e të gjitha llojeve, në kreun e trashë, u shënohet me bojë vaji të dallueshme: diametri në "cm" si numëruet dhe gjatësia në "m" si emëruet dhe matrikulla e marketimit. Trupave të ahut u zbritet 1 cm nga diametri, ndërsa trupave të dushqeve e halorëve u zbriten 2 cm.

b) Për çdo parti trupash hartohen distinat përkatëse, në të cilat volumi shprehet në m³ dhe numri i tyre në copë.

c) Lënda e rumbullakët ndahet në stiva të veçanta sipas destinacionit. Në kokën e trashë të çdo lënde shënohet diametri në cm, duke zbritur 1 cm tek ahu dhe 2 cm te halorët dhe vendoset matrikulla e marketimit.



d) Drutë e zjarrit stivohen në stiva, duke i ngritur 10 cm nga sipërfaqja e tokës, në lartësi 1.10 m nga ky bazament, e cila për efekt boshllëqesh do të llogaritet me lartësi 1 m. Sasia shprehet në metërster (m.s.t); me marrjen në dorëzim stivat shënohen me gëlqere ose bojë vaji të dallueshme. Çdo stivë ka të shënuar sasinë përkatëse.

e) Lënda për voza, për parket, elemente të ndryshme stivohen si drutë e zjarrit.

3. Depozitimi dhe stivimi në anë të rrugëve e materialit drusor të ndara në asortimente, bëhet në distanca si më poshtë:

a) Trupat e të gjitha llojeve stivohen në distancë deri 20 m nga aksi i rrugës auto, në vendet e përcaktuara në projekt, të gatshëm për ngarkim.

b) Trupat me gjatësi dhe cilësi të ndryshme, stivohen me radhë sipas kapaciteteve të terrenit.

c) Lënda e rrumbullakët, për ndërtim stivohet në distancë deri 10 m nga aksi i rrugës, e ndarë në lloje dhe cilësi, sipas përcaktimit në projekt.

d) Drutë e zjarrit, lënda për voza, për parket dhe elemente të ndryshme stivohen në distancë deri 10 m mbi aksin e rrugës. Ato mund të stivohen dhe në bankinën e rrugës, pa e bllokuar atë. Stivimi i tyre bëhet në vende që mënjanohet rreziku i marrjes së tyre nga uji dhe që lehtësohet matja dhe transportimi i tyre.

KREU IX MARRJA NË DORËZIM

1. Marrja në dorëzim e materialit drusor në anë të rrugës apo në pikat e depozitimit, kur prodhimi i tij bëhet nga kompani për llogari të DSHP-së, bëhet me komision të ngritur me urdhër me shkrim të drejtorit të shërbimit pyjor. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të seksionit të administrim-menaxhimit, seksionit të financës, nga shefi i sektorit pyjor, inspektori i zonës pyjore dhe inxhinieri i sektorit.

2. Marrja në dorëzim përmbledh veprimet administrative, teknike e financiare që vërtetojnë se shfrytëzimi është kryer në përputhje me kërkesat e paravendosura e të pranuar nga palët qysh në fillim.

3. Në datën e përcaktuar në kontratë për kolaudimin e ngastrës/nëngastrës, organet pyjore në prani të subjektit, bëjnë verifikimin e pastrimeve të kryera. Kur pastrimet janë kryer konform rregullave të përcaktuara, bëhet marrja në dorëzim.

4. Marrja në dorëzim e prodhimit bëhet me procesverbal, si rregull çdo 15 ditë. Materiali drusor dorëzohet sipas asortimenteve, duke i bashkëngjitur edhe distinat. Dokumentimi i marrjes në dorëzim kryhet në përputhje me dispozitat ligjore “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”.

5. Nëse kompania nuk realizon nxjerrjen e prodhimit dhe pastrimin e ngastrës apo nëngastrës brenda afatit të përcaktuar në kontratë dhe në lejen e shfrytëzimit, DSHP-ja mund ta shtyjë afatin deri në 2 muaj.

6. Me caktimin e afatit të ri, drejtorja dhe kompania nënshkruajnë një aneks-kontratë, ku përcaktohen detyrat që do të realizohen gjatë këtij afati.

7. Me marrjen në dorëzim përpilohet situacioni përfundimtar, mbështetur në situacionet e pjeshme provizore, i cili përmban të gjitha vëllimet e punimeve të kryera dhe vlefën totale të ngastrës/nëngastërs, sipas asortimenteve. Situacioni përfundimtar përpilohet në tri kopje dhe firmoset nga komisioni e kompania.

8. Pas dorëzimit përfundimtar dhe deri në momentin e shitjes me ankand, ruajtja dhe mirëmbajtja e materialit drusor realizohet nga kompania fituese, e cila ka rënë dakord me shkrim për këtë çështje qysh kur ka fituar tenderin. Shpenzimet që i paguhen atij për ruajtjen e materialit drusor, i ngarkohen koston së prodhimit.

9. Në periudha të thata trupat e sharrës lagen periodikisht për t’i ruajtur ato nga çarja.

10. Transporti i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera pyjore nga pylli për në destinacionin përfundimtar bëhet me vërtetim transporti, sipas modelit të miratuar, të cilat plotësohen në vend (ngastër, nëngastër).

KREU X
PËRGJEGJËSITË E KOMPANISË GJATË TRAJTIMIT TË PYLLIT DHE VJELJES SË
MATERIALIT DRUSOR DHE PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE

1. Kompania, me marrjen në dorëzim të ngastrës/nënngastrës pyjore për trajtim apo shfrytëzim, është e detyruar:

a) të zbatojë detyrimet kontraktuale;

b) të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

2. Materiali drusor i prerë (i rrezuar dhe i asortuar), që ndodhet brenda ngastrave/ nënngastrave, pas afatit të përfundimit të prerjes, nxjerrjes, pastrimit dhe kolaudimit të njësive të mbarështimit, të përcaktuara në kontratë, sekuestrohet. Në fillim ai i ofrohet për blerje subjektit të cilit i është sekuestruar, me tarifën bazë të shitjes së lëndës në këmbë.

Në rast se ai refuzon blerjen, atëherë ky material vlerësohet dhe përfshihet në mundësinë vjetore të shfrytëzimit dhe i nënshtrohet shitjes me ankand.

3. Për materialin drusor të sekuestruar sipas pikës 2, kur ai do të shitet me ankand, vlera e tij përfshihet në atë të lëndës drusore në këmbë të ngastrës/nënngastrës, ku bën pjesë. Vlera përcaktohet nga DSHP-ja, mbi bazën e analizës së kostos, duke marrë në konsideratë vlerën e lëndës në këmbë sipas tarifave në fuqi, si dhe shpenzimet e kryera nga subjekti, deri në fazën e sekuestrimit.

4. Lënda drusore në këmbë e mbetur pa u prerë, kur subjekti nuk ka kryer pagesën e këstit të fundit sipas afatit të përcaktuar në kontratë, pas inventarizimit të saj me komision nga Shërbimi Pyjor, i nënshtrohet shitjes në ankandin e radhës.

KREU XI
KËRKESAT DHE RREGULLAT PËR SHITJEN ME ANKAND TË LËNDËS DRUSORE E TË
PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE NË FONDIN PYJOR E KULLËSOR NË PRONËSI TË
SHTETIT

1. Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve në MMPAU është përgjegjëse për shitjen me ankand publik të lëndës drusore në këmbë (e paprerë) sipas kreut të parë (pikës 3, gjerat “a”, “b”), ndërsa Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP), sipas kreut të parë (pika 4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”).

2. Ankandet për shitjen e lëndës drusore në këmbë për grup-ngastrat/nënngastrat me rrugë autopjore zhvillohen dy herë gjatë vitit pyjor, në muajt shtator dhe mars të vitit pasardhës.

3. Ngastrat e planifikuara për trajtime apo prerje ripërtëritëse jepen me ankand, në nivel ngastrë, grup-ngastrash, dhe ekonomi pyjore.

4. Asortimentet e gatshme drusore të prodhuara dhe të stivuara në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi, nga kompanitë private, për llogari të DSHP-së, si dhe nxjerrja e grumbullimi nga pylli i prodhimeve të dyta pyjore, si: rrënjë shqope, mareje, bushi etj.; i rrëshirës dhe i boçeve të pishës, shiten me ankand.

5. Përgatitja dhe zhvillimi i ankandit, pas marrjes së miratimit nga Ministri, është përgjegjësi e Drejtorisë Juridike dhe Prokurimit në MMPAU dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe, për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, sipas pikës 3 dhe 4 të kreut të parë.

6. Me miratim të Ministrisë, përveç ankandit të parashikuar në pikën 4, zhvillohen dhe ankande të tjera, si në rastet emergjente, dëmtimet nga katastrofat natyrore e zjarret, gjatë ndërtimit të veprave të ndryshme, si: rrugë auto, hidrocentrale, linja tensioni të lartë etj., pavarësisht nëse janë pyje të vjetra, të reja apo në zonat e mbrojtura.

7. Me ankand shiten edhe assortimentet e sekuestruara nga strukturat e shërbimit pyjor e institucione të tjera shtetërore jashtë ngastrave pyjore. Në këtë rast, procesverbali i sekuestrimit është pjesë përbërëse e dokumenteve të ankandit. Ankandet për lëndën e sekuestruar zhvillohen sa herë paraqitet nevoja, pas datës së shpalljes së njoftimit për zhvillimin e tyre nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP).



8. Kur nuk gjendet autori i prerjes së paligjshme, nuk lejohet shitja e materialit drusor të prerë dhe asortimenteve drusore brenda ngastrës pyjore.

9. Ankandi bëhet i hapur për çdo parti asortimentesh ose për të gjitha partitë e të njëjtit asortiment që i përkasin të njëjtës cilësi dhe të njëjtit lloj drusor, si dhe për çdo njësi mbarështimi (n/gastër, ngastër të bashkuara në lote), grup-ngastra, pjesë ekonomike, ekonomi pyjore, me dhe pa rrugë autopsyjore, si edhe për prodhimet e dyta pyjore”.

10. Shitja e lëndës drusore në këmbë me ankand do të bëhet me procedurë të hapur për çdo njësi mbarështimi (n/ngastër, ngastër të bashkuara në lote), për ekonomi pyjore në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, rregullave të vendimit nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, dokumenteve standarde të ankandit publik, të hartuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)

11. MMPAU/DSHP dhe fituesi i ankandit të shpallur nga komisioni i ankandit, nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike.

12. Kur fituesi i ankandit nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk bën sigurimin e saj, nëse një gjë e tillë kërkohet, MMPAU/DSHP bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertuesve që kanë mbetur.

13. MMPAU/DSHP në rreth kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma për ekzekutimin e saj do të jetë 10% e vlerës së kontratës.

14. Me nënshkrimin e kontratës, Shërbimi Pyjor çlirohet nga çdo përgjegjësi për ruajtjen dhe dëmtimet që mund të pësojë materiali drusor i shitur.

15. Kompania fituese bën likuidimin e pagesave në DSHP pas nënshkrimit të kontratës. Pagesa bëhet sipas kësteve të caktuara në kontratë, njëherësh dhe e plotë në vartësi të sasisë së materialit drusor të fituar me ankand.

16. Për asortimentet drusore të sekuestruara, si dhe për ngastrat vetëm me dru zjarri pagesa bëhet njëherësh pavarësisht nga sasia e materialit drusor; në varësi të vëllimit drusor, kur parashikohet në kontratë, pagesa bëhet menjëherë ose me këste:

a) Për asortimentet drusore mbi 200 m³ të prodhuar e nxjerrë në anë të rrugës nga subjekte të përzgjedhura për llogari të DSHP-së, me dy këste. Afati maksimal i pagesës së kështit të dytë është 15 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës;

b) Për lëndën drusore në këmbë (lëndë punimi dhe dru zjarri), me vëllime mbi 1000 m³ me dy këste të barabarta, në datat e caktuara në kontratë. Afati i fundit i pagesës së kështit të dytë është 4 muaj para datës së përfundimit të kontratës.

17. Për çdo ditë vonesë në likuidimin e detyrimeve kontraktore, subjekti detyrohet të paguajë kamatëvonesë në masën 0,1% të vlerës së kështit përkatës. Për mospagimin e kështit të fundit brenda 15 ditëve kalendarike nga data e caktuar në kontratë dhe të kamatëvonesave, subjekti pezullohet nga veprimtaria prodhuese dhe e transportit të materialit drusor të prodhuar. DSHP-ja kërkon pagimin e detyrimit në rrugë gjyqësore.

KREU XII

KËRKESAT LIDHUR ME PJESEMARRJEN NË ANKAND TË PRERJEVE RIPËRTËRITËSE TË NGASTRAVE E GRUP-NGASTRAVE ME DHE PA RRUGË AUTOPYJORE

1. Kur kompanitë private të specializuara kërkojnë, që në zbatim të pikës 15, nenit 26 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ndërtojnë me shpenzimet e veta rrugën për shfrytëzimin e ngastrave/grup-ngastrave pa rrugë autopsyjore, krahas plotësimit të dokumenteve në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, rregullave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” dhe dokumenteve standarde të ankandit publik të hartuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), për pjesëmarrjen në ankand (konkurrim), kompania juridike duhet të plotësojë kritere dhe dokumente shtesë, si më poshtë.

2. Për shfrytëzimin e ngastrave me rrugë autopsyjore, si dhe për trajtimin e prerjet ripërtëritëse të ngastrave/grup-ngastrave pa rrugë auto e ndërtimin e rrugëve autopsyjore në to, kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm personat juridikë, të cilët plotësojnë këto kritere:

a) të kenë zhvilluar aktivitet për trajtimin dhe vjeljen e materialit drusor në pyjeve, jo më pak se 5 vjet, të dokumentuar, të vërtetuara me kontrata nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, shoqëruar me vërtetime për realizimin me sukses të tyre. Në rastin e bashkimit të operatorëve, zbatohen kriteret e krijimit të ndërmarrjeve me kapital të përbashkët me akt noterial dhe marrëveshje mbi mënyrën e operimit;

b) të kenë në pronësi kapacitete teknike e teknologjike për punime pyjore e me impakte të ulëta mjedisore, mjete transporti dhe financiare për të shfrytëzuar jo më pak se 2500 m³ lëndë drusore në vit ose aq sa është mundësia vjetore e shfrytëzimit me prerje të lejuara për ato grup-ngastra, të vërtetuara këto me bilance vjetore pozitive dy vitet e fundit, shoqëruar me inventarin e aktiveve, fatura blerje, leje qarkullimi ose të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

c) të kenë në pronësi makineri e pajisje të përshtatshme për ndërtimin e mirëmbajtjen e rrugëve autopsyjore, të vërtetuar këto me bilance vjetore, shoqëruar me inventarin e aktiveve, fatura blerje, leje qarkullimi ose të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

d) të kenë fuqi punëtore të siguruar me kontratë për 6-mujorin e fundit nga secili operator ose kryesuesi i grupit të vërtetuar me deklaram në zyrën e punës dhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve:

- për operatorët me aktivitetet në pyjet e larta në ngastrat me rrugë autopsyjore dhe pa rrugë autopsyjore, jo më pak se 20 punonjës;

- për operatorët me aktivitetet në pyjet e ulëta dhe shkurret, apo trajtime silvikulturore (pastrime rrallime) jo më pak se 10 punonjës;

e) të kenë punëtorë të certifikuar për përdorimin e mjeteve prerëse në pyje dhe pajisje e veshje speciale për sigurimin në punë të jetës së punonjësve;

f) të kenë xhiro vjetore jo më pak se 25 milionë lekë për 2 vitet e fundit për operatorët me aktivitetet në pyjet e lartë dhe mbi 5 milionë lekë për operatorët me aktivitetet në pyjet e ulëta dhe shkurret, të vërtetuar nga tatim-taksat.

Kritere pozitive vlerësimi në ankand të kenë kompanitë që kryejnë zinxhirin përpunues të lëndës drusore, përfshi përpunimin e fraksioneve të imëta të proceseve teknologjike të përpunimit të drurit, e vërtetuar me faturat e shitjes tatimore dhe doganore;

g) çdo subjekt veças apo *joint venture* të mos jetë debitor ndaj institucioneve shtetërore e private, kjo e vërtetuar nga tatim taksat;

i) të mos kenë kryer vepër penale apo kundërvajtje administrative në fondin pyjor e kullisor kombëtar”.

3. Personat juridikë, të interesuar për pjesëmarrje në ankand për ngastrat, grup-ngastrat pa rrugë autopsyjore, duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë edhe këto dokumente:

a) kërkesën me shkrim me gjeneralitetet e kërkuarit, si dhe objektin e kërkesës, përcaktimin e ngastrave e grup-ngastrave pyjore që janë të palidhura me rrugë autopsyjore dhe për të cilat shprehet interes për ndërtimin e rrugës me shpenzimet e veta, për trajtimin e shfrytëzimin e tyre;

b) studimin tekniko-ekonomik dhe programin përkatës të investimeve dhe prerjeve të hartuar nga specialistë të licencuar, i cili duhet të respektojë masat e trajtimit, të përcaktuara sipas planit të mbarështimit/inventarizimit në studimin përkatës, sipas azhurnimit të kryer vitin e fundit;

c) projektin dhe preventivin e ndërtimit të rrugës autopsyjore me të gjitha elementet përbërëse e në tri kopje, të hartuar nga specialistë të licencuar;

d) projektet teknologjike të trajtimit e të shfrytëzimit të ngastrave, grup-ngastrave pyjore, për vitin e parë të prerjes;

e) vërtetim që provon se organet e qeverisjes vendore dhe komuniteti përreth, janë dakord me zbatimin e projektit të rrugës së kërkuar, kur rruga autopsyjore kalon në fondin pyjor/kullisor komunal;

f) formularin e sigurimit të ofertës në masën 2% të vlerës së vëllimit të materialit drusor, që do të shfrytëzohet në fazën e parë të prerjeve, për grupimet e ngastrave pa rrugë autopsyjore.



g) lejen e mjedisit nga secili operator”.

4. Pranë MMPAU/DSHP ngrihet njëسيا e ankandit, përgjegjëse për zhvillimin e tij. Njëسيا e ankandit ngrihet me urdhër të ministrit, kur ankandi zhvillohet sipas kreut I (pikës 3, germat “a”, “b”) dhe drejtorit të Shërbimit Pyjor, kur ankandi zhvillohet sipas kreut I (pikës 4, germat “a”, “b”, “c”, “d”) dhe përbëhet nga jo më pak se 5 specialistë nga të gjitha fushat.

5. Njëسيا e ankandit bën vlerësimin sipas kriterëve të vlerësimit, në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi për:

a) studimin tekniko-ekonomik dhe programin përkatës të investimeve dhe shfrytëzimeve të hartuar nga specialistë të licencuar, i cili duhet të respektojë masat e trajtimit, të përcaktuara sipas planit të mbarështimit/inventarizimit në studimin përkatës, sipas azhurnimit të kryer vitin e fundit; dhe

b) projektin dhe preventivin e ndërtimit të rrugës autopsyjore me të gjitha elementet përbërëse.

6. Dokumentacioni për pjesëmarrjen në ankand dorëzohet në ditën dhe në orën e shpallur. Oferta financiare hapet pasi është bërë vlerësimi sipas pikës 5 më lart dhe është miratuar nga njëسيا e ankandit.

7. Fitues i ankandit shpallet oferta me çmim më të lartë dhe me performancë tekniko-organizative më të mirë.

8. Pas shpalljes së fituesit, një kopje e studimit tekniko-ekonomik dhe e projektit të rrugës i dorëzohet nga seksioni i administrim-menaxhimit, sektorit pyjor përkatës, për ndjekjen e zbatimit të tyre, një kopje i dorëzohet subjektit dhe e treta qëndron në seksionin e administrim-menaxhimit (protokoll). Sektori pyjor bën ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të projektit teknologjik të shfrytëzimit të ngastrave dhe të montim-çmontimit të linjave të teleferikëve dhe të instalimeve të tjera të ngjashme. Seksioni i administrim-menaxhimit bën ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të studimit tekniko-ekonomik dhe të projektit për ndërtimin e rrugës autopsyjore.

9. Me kompaninë fituese të grup-ngastrave ku do të ndërtohet rruga autopsyjore, lidhet kontrata dhe bëhet llogaritja paraprake e koeficientëve të korrektimit të tarifave bazë të lëndës drusore në këmbë, në vartësi të investimeve të parashikuara për m³ material drusor në këmbë, të përcaktuara në vëllimin total të njërive të mbarështimit në studim. Tarifat vendosen në kontratën e lidhur midis palëve, sipas legjislacionit në fuqi. Pas lidhjes së kontratës, subjekti juridik ka të drejtë ta fillojë ndërtimin e rrugës autopsyjore.

10. Trajtimi apo prerjet ripërtëritëse në ngastrat/grup-ngastrat pyjore fillon pasi merret në dorëzim segmenti rrugor, nëpërmjet të cilit tërhiqet mundësia vjetore e materialit drusor të shfrytëzueshëm, i përcaktuar sipas planit të mbarështimit të vendosur në studim. Me kompaninë lidhet kontrata e shfrytëzimit, njëlloj si për ngastrat e tjera me rrugë autopsyjore.

11. Kompania fituese e ankandit vazhdon me ndërtimin e segmenteve të tjera rrugore tërheqjen (vjeljen) e mundësisë vjetore për çdo segment, deri në përfundimin e plotë të rrugës auto dhe tërheqjen e materialit drusor, që përmbajnë të gjitha segmentet rrugore në grup-ngastrat e fituara në ankand.

12. Materiali drusor që rezulton nga hapja e trasesë së rrugës auto, vlerësohet me listëdamkë dhe pas pagesës i jepet kompanisë fituese.

13. Kolaudimi dhe marrja në dorëzim e segmenteve të rrugëve autopsyjore bëhet sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës.

14. Piketat e vendosura gjatë piketimit të rrugës ruhen deri sa të përfundojë verifikimi i punimeve të kryera dhe marrja në dorëzim e segmenteve rrugore të reja.

15. Në rast se para fillimit të punimeve ose gjatë zbatimit të projektit të ndërtimit të rrugës së re, subjektet kërkojnë të bëjnë ndryshime, për shkaqe natyrore të pamundshme për t’u parashikuar, atëherë ato pezullojnë punimet dhe i paraqesin propozimet me shkrim organeve pyjore. Propozimet e paraqitura shqyrtohen nga DPK-ja dhe miratohen vetëm në rast se ato janë në përputhje me kriteret dhe rregullat të trajtimit e pyjeve, normave, kushteve teknike e standardeve shtetërore në fuqi.

16. Me përfundimin e ndërtimit të segmenteve rrugore, kompania juridike paraqet situacionin përfundimtar të punimeve të kryera për çeljen e rrugës së re autopsyjore. Mbi bazën e raportit lekë/investime për 1 m³ lëndë drusore në këmbë, ribëhen llogaritjet për përcaktimin e koeficientëve të korrektimit të tarifave të materialit drusor në këmbë në nivelin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit të materialit drusor të përcaktuar në studim. Me tarifën e rezultuar përpilohet një aneks-kontratë, e cila i

bashkëngjitet kontratës. Në përcaktimin e koeficienteve të korrektimit do të përfshihet edhe vlera e planit të mbarështimit, në rastin e financimit të tij nga kompania private.

17. Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë për vjeljen e materialit drusor në ngastra pa rrugë autopsyjore dhe kur nga kompania kërkohet ndërtimi i rrugës me shpenzimet e veta, në vartësi të investimeve për ndërtimin e rrugës, të kryera për 1 m³ lëndë drusore në këmbë (sipas raportit lekë-investime të kryera për 1 m³ lëndë drusore në këmbë), korrektohen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

18. Për efekt të korrektimit të tarifave bazë, referimi për shpenzimet për ndërtimin e rrjetit rrugor do të jenë ato shpenzime të rezultuara nga situacioni i punimeve të kryera e të marra në dorëzim nga komisioni i organit të shërbimit pyjor për rrugët e mbërritshmërisë deri në kufirin e njësisë së mbarështimit (kategoria IV), rrugë autopsyjore (arteri kryesor brenda ekonomisë pyjore, kategori V), si dhe rrugë të kategorisë VI kryesore (nga brenda ngastrës në arterin kryesor).

19. Koha për ndërtimin e rrugës autopsyjore (segmentit rrugor) nuk përfshihet në afatin kohor për trajtimin e pyjeve. Në këtë rast, pas kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të saj, fillon pagimi i kështit të parë sipas kontratës dhe vazhdon trajtimi për një vit, deri në kolaudimin përfundimtar të ngastrës/grup-ngastrave për fazën e parë të shfrytëzimit.

20. Kompania juridike fituese e ankandit, gëzon të drejtën e trajtimit e vjeljes së materialit drusor të ngastrave/grup-ngastrave pa ankand, deri në prerjet përfundimtare, të përcaktuara në planin e mbarështimit, të vendosura në studim.

21. Kompania i humbet, pa asnjë detyrim tjetër financiar (përveç vlerës së sigurimit të ofertës dhe të kontratës), e drejta e trajtimit dhe e vjeljes së materialit drusor të ngastrave, grup-ngastrave pa rrugë autopsyjore, në rast se:

a) deri në një vit pas fitimit të së drejtës së trajtimit apo shfrytëzimit, nuk përfundon ndërtimin e rrugës autopsyjore (segmentit rrugor), sa të tërheqë (vjelë) mundësinë vjetore të shfrytëzimit për ato grup-ngastrash;

b) nuk zbaton studimin tekniko-ekonomik dhe projektin e miratuar për ndërtimin e rrugës autopsyjore;

c) nuk kryhen punimet për ndërtimin e rrugës, sipas standardeve të përcaktuara;

d) menjëherë pas ndërtimit të rrugës autopsyjore (marrjes në dorëzim), nuk fillon trajtimin apo shfrytëzimin e ngastrave/grup-ngastrave.

22. Heqja e të drejtës së trajtimit apo prerjeve, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për pyjet, me propozim të Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave.

23. Udhëzimi nr. 4, datë 25.8.2010 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup-ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, shfuqizohet.

24. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtorja Juridike dhe e Prokurimeve, Drejtorja e Pyjeve dhe Kullotave, Komisioni i ngritur për këtë qëllim në MMPAU, si dhe drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu



SHTOJCË

A. PËRMBAJTJA E STUDIMIT TEKNIKO-EKONOMIK PËR TRAJTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E GRUP-NGASTRAVE PYJORE, PA RRUGË AUTO QË DUHET TË KRYEJNË SUBJEKTET E INTERESUARA

PËRMBAJTJA E STUDIMIT

Kapitulli i parë: Qëllimi i vënies në shfrytëzim të pyjeve të grup-ngastrave

Kapitulli i dytë: Të dhëna mbi pyjet e grup-ngastrave

Kapitulli i tretë: Mbërritshmëria me rrugë auto dhe shtrirja e tyre

Kapitulli i katërt: Llogaritja e nevojave për mjete e makineri dhe personeli i punësuar

Kapitulli i pestë: Parashikimi i investimeve të nevojshme

Kapitulli i gjashtë: Efektiviteti ekonomik i studimit

Kapitulli i shtatë: Aspekti ligjor i studimit

Literaturë referuese

Hartat, skicat, foto (pjesë bashkëngjitur studimit)

KAPITULLI I PARË

QËLLIMI I VËNIES NË SHFRYTËZIM TË PYJEVE TË GRUP-NGASTRAVE

I. Në aspektin silvikultural: Origjina e grumbujve, tipi i grumbujve, forma e qeverisjes, faza e zhvillimit, biodiversiteti, lloji drusor, kurorëndësia, struktura vertikale, homogjeniteti, ripërtëritja natyrore, bimësia barishtore, lëgusha, të dhënat dendrometrike (diametri mesatar, lartësia mesatare), gjendja fitosanitare.

Konkluzione (lidhur me vënien në shfrytëzim)

II. Në aspektin social

Konkluzione (lidhur me vënien në shfrytëzim)

III. Në aspektin ekonomik

Funksioni kryesor i pyjeve të grup-ngastrave, funksione të veçanta, klasa e prodhimit, grumbujt pyjorë, ndarë sipas këtyre klasave.

Disa tregues lidhur me prodhimtarinë e tyre të përcaktuar nga mbarështimi i vitit të fundit, si: trung dendësia, rritja vijuese, cilësia e grumbujve, ndërhyrjet e mëparshme, infrastruktura.

Konkluzione (lidhur me qëllimin e vënies në shfrytëzim) ndërhyrjet silvikulturale, materiali drusor, vlerësimi ekonomik.

IV. Në aspektin ekologjik

Territori i shtrirjes së pyllit: konfiguracioni, kundrejtimi, lartësia mbi nivelin e detit, pjerrësia, pH i tokës, tipi i tokës, thellësia, lagështia, shkëmbi amnor, gurët në sipërfaqe, trashësia e humusit, struktura, tekstura, hidrografia, erozioni, ortekët, disa tregues klimatikë, bimësia.

Konkluzione (lidhur me qëllimin e vënies në shfrytëzim).

Qëllimi i vënies në shfrytëzim (në aspektin ekologjik) të pyjeve, duhet të sigurojë: shërbimet ekologjike, njohjen dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore të ndërhyrjeve me prerje shfrytëzimi të grumbujve dhe evidentimin e vlerave mjedisore të grumbujve pyjorë.

KAPITULLI I DYTË

TË DHËNA MBI PYJET E GRUP-NGASTRAVE

- Vendndodhja

- Sipërfaqja totale

- Llojet përbërëse dhe vëllimet e tyre

a) Vendndodhja, sipërfaqja totale, llojet përbërëse e vëllimet e tyre.

Tabela 2a

Numri i ngastrës	Ek.pyjore	Emërtimi i ngastrës	Lloji drusor	Sip.ha	Vëllimi drusor m ³		
					Gjithsej	Lëndë punimi	Dru zjarri
SHUMA							

b) Vëllimi total i shfrytëzueshëm sipas klasave të pjerrësisë së ngastrave, llojeve drusore, klasave të prodhimit.

Tabela 2b

Numri i ngastrës	Klasa e parë e pjerrësisë (0-20%), vëllimi drusor i shfrytëzueshëm						
	Sip. ha	Lloji drusor	Klasa e prodhimit	Vëllimi lëndë punimi në m ³			dru zjarri
				totali	e hollë	mes+ trashë	
TOTALI							

Orientohet grupi i ngastrave pyjore në 4 klasa, si:

- Klasa I 0-20% pjerrësi
- Klasa II 21-40% pjerrësi
- Klasa III 41-60% pjerrësi
- Klasa IV mbi 61% pjerrësi

- Vëllimi total i shfrytëzueshëm sipas klasave të pjerrësisë së ngastrave, llojeve drusore, klasave të prodhimit.

Tabela 2b

Numri i ngastrës	Klasa e dytë e pjerrësisë (21-40%), vëllimi drusor i shfrytëzueshëm						
	Sip. ha	Lloji drusor	Klasat e prodhimit	Vëllimi lëndë punimi në m ³			dru zjarri
				Totali	e hollë	mes+ trashë	
TOTALI							

- Vëllimi total i shfrytëzueshëm sipas klasave të pjerrësisë së ngastrave, llojeve drusore, klasave të prodhimit.

Tabela 2b

Numri i ngastrës	Klasa e tretë e pjerrësisë (41-60%), vëllimi drusor i shfrytëzueshëm						
	Sip. ha	Lloji drusor	Klasat e prodhimit	Vëllimi lëndë punimi në m ³			dru zjarri
				Totali	e hollë	mes+ trashë	
TOTALI							
GJITHSEJ							

b) Mundësia vjetore e shfrytëzimit (repriza e parë), sipas gjendjes silvikulturale të grumbujve.

Tabela 2c

Numri i ngastrës	Sip.ha	Lloji drusor	Vëllimi i lëndës drusore sipas planit mbarështimit (azhurnimit të vitit të fundit) m ³				% e heqjes ndaj totalit	Vëllimi drusor që do të hiqet (vilet) në fazën e parë të prerjes m ³				Viti i prerjes
			gjithsej	L. punimi		dru zjarri		gjithsej	l.punimi		dru zjarri	
				E hollë	m+tr.				hollë	m+tr.		



Rritja vjetore e pyjeve të grup-ngastrave

Tabela 2d

Numri i ngastrës	Sip.ha	Lloji pyjor	Rritja vjetore Rmv = m ³ /ha	Total Rm = m ³ /vit

Konkluzion lidhur me kuotën vjetore të shfrytëzimit të materialit drusor në grup-ngastrat.

c) Vlerësimi industrial i fuqisë lëndore për mundësinë vjetore të shfrytëzimit

Tabela 2d/1

Asortimentet sipas llojeve	Lëndë punimi								Dru zjarri	
	e hollë		e mesme		e trashë		Gjithsej		%	m ³
	%	m ³	%	m ³	%	m ³	%	m ³		
Trupa										
L. ndërtimi										
Dru zjarri										
TOTALI										

Përmbledhëse, vlerësimi industrial sipas llojeve drusore.

Tabela 2d/2

Asortimentet	Njësi matjes m ³	Llojet drusore			
		ah	p.zezë	Gjithsej
Trupa					
L. ndërtimi					
Dru zjarri					
TOTALI					

Asortimentet neto

Tabela 2d/3

Asortimentet	Bruto m ³	Humbje		Neto m ³
		%	m ³	
Trupa				
L. ndërtimi				
Dru zjarri				
TOTALI				

KAPITULLI I TRETË

MBËRRITSHMËRIA ME RRUGË AUTO DHE SHTRIRJA E TYRE

a) Mbërritshmëria konsiston në:

- Lidhjen me rrjet të rrugëve autoekzistuese, nëpërmjet projektimit të rrugëve auto të kategorisë IV deri në hyrje të pyjeve që do të shfrytëzohet. Kjo rrugë është me kushte teknike të miratuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

- Lidhjen me rrjet rrugor të kategorisë V dhe VI ngastrave pyjore, sipas radhës së futjes në shfrytëzim të përcaktuar nga plani i mbarështimit. Rruga auto e kategorisë V është me kushte teknike të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, ndërsa rruga e kategorisë VI është me kushte teknike të miratuara nga ish-DPPK-ja.

b) Shtrirja e rrjetit rrugor:

Mbulimi me rrjet rrugor për lehtësimin e hyrjes së njerëzve dhe mjeteve të punës, nxjerrjen e materialit drusor dhe prodhimeve të tjera, si dhe mbarështimi e qeverisja e fondit pyjor në përdorim, do

të bëhet me rrugë auto të kategorisë V e VI kryesore VI sekondare. Rruga auto e kategorisë VI është me bazament artificial ose të përmirësuar (kalldrëm, çakëll, zhavorr), në të cilën do të lëvizin automjete dhe traktorë me rimorkio, për transport material drusor.

Për mbulimin me rrjet rrugor duhet orientuar me treguesit bazë, si: “dendësia optimale” në ml/ha dhe “hapësira optimale” midis tyre e shprehur në ml, realizimi i të cilave bën të mundur zbatimin e një silvikulture racionale.

Sipas klasave të pjerrësisë, rekomandohen:

Klasa e pjerrësisë	Sip.ha	Dendësia optimale (ml/ha) rrugë kategoria e V+VI		Hapësira optimale midis tyre (ml) në rast ndërtimi të rrugëve kategoria VI/S	
		optimale	e projektuar	optimale	e projektuar
Klasa I		10-15		2000	
Klasa II		15-25		1000	
Klasa III		25-35		500	
Klasa IV		35-40		350	

Dendësia e mbulimit me rrjet rrugor është (e mesatarizuar):

..... ml : ha =ml/ha

Studimit të paraqitur do t'i bashkëngjitet harta e zonës, në të cilën përfshihet harta e ekonomisë pyjore, pjesës ekonomike ose grup-ngastrave në shkallën 1:25000 e ndarë në ngastra dhe n/ngastra, si dhe rrjeti rrugor i trasuar sipas kategorive respektive. Gjithashtu, do të jepen volumet kryesore të punimeve dhe preventivi përmbledhës.

Në pasqyrën e mëposhtme do të jepen të dhëna të rrjetit rrugor:

Klasa e pjerrësisë	Ngastrat	Sipër. ha	Vëllimi drusor m ³			Gjatësia totale e rrugëve të rreja në km			
			Gjithsej	L.punimi	D.zjarri	Gjithsej km	V	VI/k	VI/S

Rezultatet e studimit

Nr.	Emërtimi	Njësi matjes	Rezultatet e studimit	Kufijtë optimalë
1	Dendësi e rrjetit rrugor	ml/ha		12-13
2	Dendësi e rrugëve sipas pjerrësisë terreneve:	ml/ha		
a)	Terrene të klasave I-II	ml/ha		10-20
b)	Terrene të klasave II-III	ml/ha		20-30
c)	Terrene të klasave III-IV	ml/ha		30-40

Tregues (të mesatarizuar) dhe të evidentuar

- Sipërfaqja totale e grup-ngastrave = ha.
- Dendësia e rrjetit rrugor = ml/ha (optimumi varion nga 10-25 ml/ha).
- Hapësira optimale midis tyre = 500-2000
- Për çdo km rrugë e re (aks kryesor + degëzime) brenda grup-ngastrave potencialisht nxirret material drusor = m³/km.



KAPITULLI I KATËRT
LLOGARITJA E NEVOJAVE PËR MJETE E MAKINERI DHE PERSONEL I PUNËSUAR

- a) Mekanizimi i punimeve do të trajtohet për:
- ndërtimin e rrugëve auto
- transportin e brendshëm, të kombinuar me krahë deri 25% dhe e mekanizuar 75%
- zgjedhja e mekanizmit të nevojshëm
Pasqyra e shkallës së mekanizimit të transportit të brendshëm

Ngastra	Lëndë punimi m ³	Me krahë		Me traktor		Gjithsej me krahë		Gjithsej me mekanizma	
		m ³	%	m ³	%	m ³	%	m ³	%

Llogaritja e distancës mesatare të transportit të brendshëm.

Ngastra	Lëndë punimi m ³	Lëndë punimi transport me:		Distanca mesatare e transportit me:	
		krahë (m ³)	traktor (m ³)	krahë (m ³)	traktor (m ³)

- b) Zgjedhja e mekanizimit të nevojshëm dhe llogaritja e sasisë së nevojshme.
Zgjedhja dhe llogaritja e mekanizmave të nevojshëm do të bazohet në natyrën e punimeve dhe sasinë e tyre për:

1. ndërtimin e rrugëve auto;
2. prerjen e drurëve dhe transportin e brendshëm të materialit drusor;
3. ngarkimin (trupa, dru zjarri etj.) dhe transportin e jashtëm (i largët) i materialit drusor.

Tipi dhe sasia e mekanizmave që kërkohen:

Nr.	Emërtimi i makinerisë	Tipi, karakteristikat teknike	Njësi e matjes	Sasia	Çmimi për njësi 000/lekë	Total në 000/lekë
I.	Për ndërtimin e rrugëve autopyjore					
1	Traktor me ruspë hidraulik					
2	Mjet ngarkues					
3					
II.	Prerje dhe transport të brendshëm					
1.	Motosharra					
2	Traktor vetëngarkues					
III.	Për ngarkim e transport të jashtëm					
1.	Autovinç					
2.	Kamion					
	TOTALI					

Në varësi të mundësisë vjetore të shfrytëzimit dhe të mekanizmave që do të nevojiten, përcaktohet numri i personelit të punësuar:

Numri i personelit të punësuar në vit

Nr.	Makineri e pajisje	Njësia e matjes	Numri i mekanizmave	Personeli i punësuar
1	Traktor s-150	copë		
2	Traktor ngarkues pyjor	“		
3	Kamion vetëshkarkues	“		
4	Motosharra	“		
5	Traktor me zinxhirë	“		
6	Autovinç	“		
7	Kamionë transporti	“		
8	Linja e sharrimit dhe e prodhimit të elementeve për eksport	“		
	TOTALI			

**KAPITULLI I PESTË
PARASHIKIMI I INVESTIMEVE TË NEVOJSHME**

Në investimet e nevojshme në studim të llogariten:

- a) Vlera e investimit të rrjetit rrugor të ri, sipas kategorive të ndryshme, si dhe infrastrukturës së nevojshme;
- b) Vlera e investimit për pajisje dhe mekanizma, ku përfshihen vetëm makineritë për hapjen e rrugëve, transportin e brendshëm dhe atë të jashtëm;
- c) Vlera e investimit për punime plotësuese:
 - punime për ripërtëritjen artificiale, në rreth 5 % të sipërfaqes në vit;
 - punime për mbrojtjen nga zjarret, në rreth 2 % të sipërfaqes në vit;
 - punime për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga sëmundjet, përkujdesja ndaj punonjësve (kushtet e punës, lëvizjen apo ngritjen e kampingjeve), në rreth 5% të sipërfaqes në vit.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera në 000/lekë
1	Rrjeti rrugor	
2	Makineri e pajisje	
3	Punime plotësuese	
	SHUMA	

**KAPITULLI I GJASHTË
EFEKTIVITETI EKONOMIK I STUDIMIT**

I. Investimi gjithsej në (000/lekë)

- a) Makineri e pajisje
- b) Rruga auto
- c) Punime plotësuese

II. Prodhimi mall i shitur në m³ dhe 000/lekë

- Nga kjo: a) eksporti
b) vendi

Nr.	Asortimenti	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefata në 000/lekë	Shitja	
						Vendi 000/lekë	Eksporti 000/lekë
1	Lëndë ndërtimi	m ³					
2	Shtylla	m ³					
3	Dru zjarri	m ³					
4	Lëndë e sharruar	m ³					
5	Elemente druri (1/2 përpunuar)	m ³					
	TOTALI						



III. Fitimi në 000/lekë:

- a) fitimi
- b) tatim fitimi
- c) fitimi neto

Nivelet e pagës mesatare:

- për punëtorë prodhimi do të jetë të 18 000 lekë/muaj;
- për punonjës administrate 35 000 lekë/muaj.

IV. Rentabiliteti

Pasqyra e rezultatit ekonomik në 000/lekë në vit.

Nr.	Asortimentet drusore sipas llojeve	Njësi matjes	Sasia	Kostoja e prodhimit	Çmimi i shitjes	Shpenzime prodhimi (B) 000/lekë	Të ardhura bruto (A) 000/lekë	Të ardhura neto (A-B) 000/lekë
1	L. ndërtimi							
2	Shtylla							
3	Dru zjarri							
4	Lëndë sharruar							
5	Elemente druri							
	TOTALI							

Fitimi 000/lekë = A - B

rentabiliteti = e ardhura neto

shpenzime prodhimi (total)

- Te prodhimi mall i shitur në 000/lekë për eksport dhe vend, kemi parasysh prodhimin gjysmë të gatshëm dhe të gatshëm (produkti).

- Te nivelet e pagës mesatare janë pagat e miratuara sipas VKM.

Për punëtor prodhimi 18000 lekë/muaj

Për personel administrate 35000 lekë/muaj

Me indeksimin e herëpashershme të pagave do të ndryshojnë edhe pagat e mësipërme.

- Te rentabiliteti, rekomandohen nivelet:

Minimale 10 %

Mesatare 15 %

Maksimale 30 %

Niveli minimal është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga subjektet.

KAPITULLI I SHTATË ASPEKTI LIGJOR I STUDIMIT

Porositi studimin:

Studimi u realizua me kërkesë porosi të subjektit ... sh.p.k. me seli në rrethin e

Kërkesa bazohet në ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007, neni 10 pika 15 sipas të cilit "Kur subjekti privat i specializuarderi në prerjet përfundimtare".

Subjekti juridik sh.p.k. identifikohet me dokumentacionin ligjor:

Është regjistruar si subjekt me vendim gjykate nr.

a) Është i regjistruar në organet tatimore me numër NIPTI -

b) Është i pajisur me licencë nga QKL-ja nr. dhe i regjistruar në QKR.

c) Subjekti shlyen detyrimet financiare sipas legjislacionit financiar të shtetit të vërtetuar në vijimësi nga dega e tatimeve.

Aktualisht subjekti ... sh.p.k. ka të punësuar punonjës në vit dhe me vënien në zbatim të këtij studimi numri i punonjësve të punësuar rritet në ... veta.

- Përvoja e subjektit juridik ... sh.p.k.
- Objekte, pajisje tregu
- Personeli për administrim e zbatim të veprimtarisë

Projektet e rrugëve autopsyjore duhet të përmbajnë:

- hartën në shkallë 1:25000;
- planimetrinë me të gjitha detajet (elementet) në shkallën 1:1000;
- profilin gjatësor shkallë horizontale 1:1000 e shkallë vertikale 1:100;
- profilin tërthor në shkallë horizontale 1:1000 e shkallë vertikale 1:100;
- plani i situacionit në shkallë 1:1000.

Kushtet teknike të projektimit të rrugëve auto

Këto kushte teknike shtrihen në studimin dhe projektimin e rrugëve të reja që do të ndërtohen.

Zgjedhja e drejtimit të rrugës autopsyjore të re, që do të ndërtohet duhet bërë duke pasur parasysh perspektivën e zhvillimit ekonomik të zonës, kryqëzimet me rrugët, hekurudhat dhe që të bëhet sa më aktive lidhja e rrugës që do të ndërtohet me rrjetin ekzistues.

Projektimi i rrugëve auto nga pika e nisjes deri në mbërritje, si rregull, duhet të kalojë nëpër drejtimin më të shkurtër.

Përcaktimi i kategorisë së rrugës së re që do të ndërtohet bëhet që në fillim mbi bazën e dendësisë së lëvizjes dhe rëndësisë ekonomike.

Për shfrytëzimin e pyjeve përdoren këto kategori rrugësh auto:

Kategoria IV: Përdoren për lidhjen e ekonomisë pyjore që do të shfrytëzohet, me rrjetin e rrugëve autonacionale.

Kategoria V: Përdoren rrugët auto brenda ekonomisë pyjore që shërbejnë si arter kryesor.

Kategoria VI: Përdoren rrugët auto brenda ngastrave që lidhen me rrugët e kategorisë V. Këto rrugë i kemi ndarë për qëllimin e hapjes dhe rëndësisë, në rrugë auto të kategorisë VI kryesore dhe sekondare.

Rrugët e kategorisë VI kryesore shërbehen nga automjete transporti, ndërsa ato të kategorisë VI sekondare nga traktorë me goma.

Më poshtë po japim kushtet teknike të projektimit të rrugëve auto të miratuara, që do të përdoren nga drejtoritë e shërbimit pyjor.

Elementet teknike të rrugës	Njësia e matjes	Kategoria e rrugës			
		IV	V	VI	
				kryesore	sekondare
- Shpejtësia e projektuar	km/orë	30	20	15	12
- Numri i kalimeve	nr.	1	1	1	1
- Gjerësia e brezit të kalimit	ml	4	3.5	3	2.5
- “ e bankinës	ml	0.75	0.5	0.5	0.5
- “ e trupit të rrugës	ml	4.75	4	3.5	3
- Numri i bankinave	nr.	1	1	1	1
- Pjerrësia maksimale gjatësore	%	11	12	12	12
- “ “ tërthore	%	7	5	4	4
- Kundërpjerrësia maksimale	%			10	12
- Rrezja minimale	ml	20	12	10	8
- Nr. i vendeve të ndërrimit për km	nr.	5	4	3	2
- Gjatësia e vendeve të ndërrimit	ml	20	20	15	10



B. KRITERET E VLERËSIMIT TË STUDIMIT TEKNIKO-EKONOMIK PËR SHFRYTËZIMIN E PJESËVE EKONOMIKE DHE GRUP-NGASTRAVE, QË VIHEN PËR HERË TË PARË NË SHFRYTËZIM

Sipas përmbajtjes së studimit, njësia e ankandit e ngritur në DSHP për vlerësimin e këtij studimi, do të zbatohet këto kritere:

1. Mbështetja ligjore e treguesve ekonomikë

a) Vëllimi i shfrytëzueshëm sipas planit të mbarështimit;

b) Trajtimi (metoda e prerjes);

c) Vëllimi vjetor i prerjeve dhe mundësia vjetore sipas planit mbarështimit.

(Vlerësimi me konsideratë për bazueshmëri të plotë.)

2. Mbështetja tekniko-silvikulturale

a) Mbërritshmëria me rrugë auto dhe shtrirja e tyre (ndihmesa sociale e variantit të rrugës).

- Mbërritshmëria: Konsiston në lidhjen me rrjet rrugor të kategorisë IV me kufirin e fillimit të njësisë së mbarështimit që do të shfrytëzohet. Varianti i zgjedhur nga subjekti për kalimin e rrugës auto është kompetencë e vetë subjektit dhe vlerësimi i një varianti kundrejt tjetrit do të bëhet pa pikë, por duke marrë në konsideratë atë variant rruge që plotëson më mirë zgjidhjen sociale të zonës.

- Shtrirja e rrjetit rrugor: Për mbulimin e njësive të mbarështimit që do të shfrytëzohen nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti rrugor, do të përdorim treguesit e “dendësisë optimale” sipas “hapësirës optimale” midis tyre, në funksion të klasave të pjerrësisë, të shprehura në përmbajtjen e studimit:

b) Dendësia optimale e rrjetit rrugor: 10ml/ha = 5 pikë dhe për çdo 1ml mbi 10ml/ha jepet 1 pikë.

“Dendësia optimale”

1 pikë 10-15 ml/ha 5 pikë

1 pikë 15-25 ml/ha 10 pikë

1 pikë 20-35 ml/ha 10 pikë

1 pikë 30-40 ml/ha 5 pikë

Për minimumin e dendësisë optimale jepet 1 pikë, si dhe për çdo ml/ha dendësi, jepet 1 pikë.

Pikë të detyrueshme janë vlerat minimale, sipas klasave të pjerrësive.

c) Kategoria e rrugëve

Rrjeti rrugor që mbulon njësitë e mbarështimit, që do të shfrytëzohet, do të shpërndahet sipas kategorive të rrugëve:

- Kategoria V 50 pikë 30-50 % 150 pikë

- Kategoria VI kryesore 90 pikë 50-30 % 30 pikë

- Kategoria VI sekondare 20 pikë 20 % 20 pikë

160 pikë 200 pikë

Për kategorinë V të rrugës vlerësimi është 5 pikë për 1 %, që zë në totalin e rrjetit rrugor të ri.

Për kategorinë VI kryesore të rrugës vlerësimi është 3 pikë për 1 %.

Për kategorinë VI sekondare të rrugës vlerësimi është 1 pikë për 1 %.

Lejohet kompensimi i kategorive të larta të rrugëve auto me ato të ulëta, gjithmonë pa prishur minimalen dhe maksimalen e mundshme të pikëve.

Pikë të detyrueshme janë 160.

d) Mekanizimi i punimeve për transportin e brendshëm.

Do të vlerësohet me pikë, vetëm transporti i brendshëm në raportet:

25 % me krahë 25 pikë

75 % me mekanizëm 300 pikë

100 % 325 pikë

- Për transportin me krahë vlerësimi është 1 pikë për 1 %.

- Për transportin me mekanizëm vlerësimi është 4 pikë për 1 %.

Brenda shumatores prej 100 % transporti i brendshëm lejohet ulja e % se transportit me krahë dhe zëvendësimi me transportin me mekanizëm, ndërsa e kundërta jo.

(Vetëm kur transporti i brendshëm sillet në raportet rreth 25 % me krahë dhe 75 % me mekaniz.)

Pikë të detyrueshme për vlerësimin janë 325.

Mekanizimi i punimeve të operacioneve të tjera, si: prerja, ngarkimi, ndërtimi i rrugëve auto, vlerësimi do të bëhet me konsideratë për mekanizimin e punimeve.

e) Zgjedhja e mekanizimit të nevojshëm:

Vlerësimi i tipit të mekanizmave për transportin e jashtëm dhe ndërtimin e rrugëve auto pyjore nuk do të jetë me pikë, por do të bëhet mbi bazën e konsideratës për tipat më të avancuar të kohës, që sjellin më pak pasoja negative në mjedisin pyjor për:

Transportin e brendshëm: motosharra, traktor vetëngarkues, traktor pyjor me zinxhirë, teleferikë të ndryshëm të tipave të fundit etj.

Transportin e jashtëm: kamion transporti me kapacitet mbajtës 8 tonë e lart; kamion vetë shkarkues; autovinç për ngarkim lëndë drusore.

Ndërtimin e rrugëve autopajore: traktor me ruspë hidraulike; traktor s-150; ekskavator, kamion me karroceri mbajtës mbi 8 tonë; kamion me karroceri (ripontabël) me kapacitet mbi 8 tonë;

3. Program i masave zbutëse të impakteve mjedisore.

a) Punime rehabilituese të parashikuara (nga 50-100 pikë)

- Investim minimal = 50 pikë

- Investim maksimal = 100 pikë

b) Program i masave zbutëse:

- I detajuar = 100 pikë

- I pjesshëm = 50 pikë

4. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe leverdi ekonomike

a) Siguron vijueshmëri prodhimi

Metoda dhe teknika e trajtimit të garantojnë mbrojtjen e pyllit dhe sigurojnë pyllin e së ardhmes.

Vlerësimi do të jetë me konsideratë.

b) Efekti ekonomik i studimit:

- Prodhimi mall i shitur m³ dhe 000/lekë

Vlerësimi do të jetë me konsideratë, ku: primare do të jetë produkti i gatshëm kundrejt atij gjysmë të gatshëm dhe prodhimi për eksport kundrejt atij për vend.

c) Nivelet e pagës mesatare:

- për punëtor prodhimi 18.000 lekë/muaj;

- për personel administrate 35.000 lekë/muaj.

Këto nivele minimale janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në të kundërt nuk bëhet vlerësimi i studimit të paraqitur nga subjekti.

Vlerësimi është:

100 pikë për pagën 18.000 lekë/muaj;

150 pikë për pagën 35.000 lekë/muaj.

Mbi këto paga pune do të jepet 10 pikë për çdo 1000 lekë për shtesë page në muaj.

Sa herë që do të bëhet indeksimi i pagave, do të pasqyrohet edhe ndryshimi i tij.

d) Rentabiliteti

- Minimal 10%, vlerësohet me 100 pikë;

- Mesatar 20 %, vlerësohet me 200 pikë;

- Maksimal 30 %, vlerësohet me 300 pikë.

Vlerësimi do të jetë 10 pikë për çdo 1 % shtesë rentabiliteti.

Rentabiliteti minimal është i detyrueshëm.

5. Kapacitete zbatuese të mjaftueshme për të realizuar në kohë detyrimet kontratale:

a) Fuqi punëtore të kualifikuar

b) Mekanizma të duhur e të mjaftueshëm për operacionet prodhuese e transportuese.



Vlerësimi: me konsideratë bazuar në treguesit e aktivitetit jo më pak se 5 vjet (i dokumentuar).
c) Mundësi financiare të subjektit për të kryer aktivitetin.
6. Besueshmëria e subjektit për të kryer aktivitetin.
Vlerësimi me konsideratë, sipas dokumentacionit të paraqitur lidhur me zhvillimin e aktivitetit për trajtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve me jo më pak se 5 vjet, i dokumentuar.
Në total, pikë të detyrueshme janë 895 pikë.
Vlerësimi me konsideratë përcaktohet me shumicën e vlerësimeve: mjaftueshëm, mirë, shumë mirë.

URDHËR
Nr. 19, datë 26.2.2013

**PËR MIRATIMIN E “PROGRAMIT KOMBËTAR TË KONTROLLIT TË CILËSISË SË
SIGURISË NË AVIACIONIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 106 pika 2 (iii) të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit kombëtar të kontrollit të cilësisë së sigurisë në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij programi.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

VENDIM
Nr. 26, datë 28.2.2013

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S PËR VITIN 2012

Në zbatim të neneve 9 dhe 10 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 28.2.2013, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s për vitin 2012, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëngjitur këtij vendimi).
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

KËRKESE

Shtetasja Vildane Kucuku, e bija e Fejzos dhe e Bedries, e datëlindjes 18.6.1953, banuese në Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të babait të saj, shtetasit Fejzo Veip Kucuku.

KËRKUESE
Vildane Kucuku

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 12.3.2013
Doli nga shtypi më 13.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë